



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 01.07.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Prezantimi i projektligjit “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Mucmata, Petrit Vasili.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

**Të ftuar:**

Gent Ibrahim, ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard, eksperte e Nivelit të Lartë, zëvendës shefe e Misionit EURALIUS

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sipas kalendarit të punës së komisionit, në rendin e ditës kemi dy çështje: e para, është prezantimi i projektligjit “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”; e dyta, është shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës: prezantimi i projektligjit “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”. Projekti u është shpërndarë deputetëve. Njëkohësisht, ka kohë që është në faqen e internetit të reformës, si edhe u është shpërndarë me *email* të gjithë gjyqtarëve të Republikës, së bashku me dy projektligjet e tjera, që lidhen me fushën e gjyqësorit, në mënyrë që ata të kenë mundësi të njihen me versionin final, për shkak se kanë pasur mundësi të njihen me draftin gjatë gjithë procesit të konsultimit publik, që është zhvilluar me ta, dhe të japin vlerësimet, opinionet, komentet, sugjerimet që kanë për projektligjin që është duke u prezantuar, si edhe për dy projektligjet e tjera të sistemit të fushës së gjyqësorit. Njëkohësisht, stafi do të ketë detyrën dhe përgjegjësinë që t’u dërgojë të gjithë prokurorëve të Republikës, më saktë të gjithë rrjetit të konsultimit prej 1900 adresash që ne disponojmë, edhe dy projektligjet që lidhen me fushën e drejtësisë penale, në mënyrë që të fitojmë kohë, pavarësisht se një pjesë e tyre nuk janë prezantuar ende. Por, për sa kohë që i kemi të depozituara në Kuvend, t’ia dërgojmë çdo pjesëtari të këtij *network*-u, në mënyrë që ata të kenë mundësi që, krahas kontributit që kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit publik, që është organizuar për këto projektligje, t’i shohin ato në versionin e tyre final për shqyrtim nga komisioni dhe të japin opinionet, vlerësimet dhe komentet e tyre. Kjo është për t’u bërë të njohur kolegëve procedurën që jemi duke ndjekur, në funksion edhe të transparencës së procesit.

Pra, fillojmë me projektligjin “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”. Të pranishëm në komision janë: zonja Agnese Bernhard, që është bashkëdrejtuese e grupit të gjyqësorit në përbërje të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë punuar në të gjithë këtë proces të draftimit të projektit kushtetues dhe të projektit të ligjeve, si edhe zoti Genti Brahimi, i

cili është, gjithashtu, bashkëdrejtues i këtij grupi të ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtarë. Zonja Bernhard dhe zoti Ibrahim do të bëjnë një paraqitje të shkurtër të përmbajtjes së projektit, kryesisht të risive që sjell. Po e them këtë, sepse është bërë si forcë zakoni, por i gjithë ky projekt përbën një risi, kështu që nuk mbetet gjë tjetër veçse t'ju dëgjojmë.

Fjalën e ka fillimisht zoti Ibrahim.

**Gent Ibrahim** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç e thatë edhe ju, sot në tryezë kemi projektligjin “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili natyrisht në vetvete është një risi, sepse risi janë vetë organet, siç i ka parashikuar ato drafti kushtetues. Në thelb, ky është një projekt i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të reja qeverisëse të sistemit, ashtu siç i parashikon drafti kushtetues. Me fjalë të tjera, këtu ka rregulla për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili është një evoluim i Këshillit aktual të Drejtësisë; rregulla për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili është një organ i ri, të paktën me statusin kushtetues; rregulla për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që janë praktikisht identike me ato të Këshillit të Lartë Gjyqësor; rregulla për organizimin dhe funksionimin e institucionit të ri të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe së fundi rregulla për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Deri në datën 14 qershor ky projekt trajtonte edhe një institucion tjetër, që ishte Tribunali i Drejtësisë, por në versionin e rakorduar të draftit kushtetues të datës 14 qershor, nuk është më Tribunali, kështu që ky projektligj vjen paksa më i lehtësuar nga volumi për këtë shkak. Në përgjithësi ligji fillon duke trajtuar...

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, por kemi rënë dakord që në vend të tij do të shtohet pjesa që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës dhe ju keni marrë përsipër ta sillni në fillim të javës.

**Genti Ibrahim** – Po. Ju e dhatë, në njëfarë mënyrë, autorizimin që pjesë e këtij projektligji të bëhej edhe projektligji aktual për Shkollën e Magjistraturës, i cili pas vendimit tuaj do të duhet të jetë një kapitull i kësaj Shkolle. Ne jemi shumë dakord me këtë ide. Ai depozitohet sot pranë jush. I vetmi përjashtim, që kërkojmë nga seti i detyrimeve që na lindin në detyrën tonë si ekspertë, është që kapitullin për Shkollën e Magjistraturës të mos e shqyrtojmë ditën e hënë nen për nen, por të kemi një mundësi tjetër, duke qenë se do të duhet pak kohë për ta integruar me pjesën tjetër të projektit.

Për sa i takon përmbajtjes së këtij projekti, natyrisht që këtu ka shumë risi. Duke pasur parasysh revolucionin që ka bërë drafti kushtetues për sa i takon përbërjes së organeve qeverisëse të gjyqësorit dhe të prokurorisë, e kam fjalën për demokratizimin e përbërjes së tyre me anëtarë që vijnë nga avokatia, nga noteria, nga trupa e pedagogëve, nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga shoqëria civile, ky projektligj natyrshëm i kushton një kujdes shumë të veçantë mënyrës së përzgjedhjes së kandidatëve. Të gjithë jemi koshinetë që është shumë bukur nga ana politike të krijosh mundësinë që grupet e interesit të përfaqësohen nga organet qeverisëse, por ky është një proces shumë delikat, i mbushur me kurthe, i mbushur me mundësi për abuzim, qoftë me mundësi për abuzim nga politika, qoftë me mundësi për abuzim nga nëngrupet e interesit brenda grupeve të interesit. Pra, për ta thjeshtuar atë që thashë: një proces zgjedhor që bëhet nga radhët e avokatisë, mund të influencohet në mënyrë të pandershme nga politika, por mund të influencohet edhe nga një grup i fortë brenda këtij grupi interesi. Ky projektligj i reflekton këto shqetësime dhe përpiqet të japë zgjidhje për të gjitha këto.

Siç e keni parasysh, projekti kushtetues parashikon një përbërje mikse të Këshillit të Lartë Gjyqësor me 11 anëtarë, 6 prej të cilëve janë gjyqtarë. Projekti përmban rregulla shumë të imta për mënyrën e përzgjedhjes dhe për nominimin përfundimtar të kandidatëve gjyqtarë. Ashtu siç e kërkon edhe projekti i Kushtetutës, projektligji siguron përfaqësimin e të gjitha shkallëve të gjyqësorit nëpërmjet një sistemi kuotash. Ajo që propozohet është që në radhët e 6 anëtarëve gjyqtarë, 3 të jenë gjyqtarë të Shkallës së Parë, 2 të jenë gjyqtarë të Shkallës së Apelit dhe 1 të jetë gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Edhe brenda këtyre kuotave, pra brenda grupit të gjyqtarëve të Shkallës së Parë dhe grupit të gjyqtarëve të Shkallës së Apelit, ne bëjmë një ndarje, pra kërkojmë në këtë projektligj që të paktën 1 prej këtyre 3 gjyqtarëve të Shkallës së Parë të vijë nga një gjykatë jashtë Tiranës dhe të paktën 1 nga ata 2 gjyqtarët e Shkallës së Apelit të vijë nga një gjykatë jashtë Tiranës. Kjo është një kërkesë e qartë që na ka ardhur gjatë procesit të konsultimeve nga gjyqtarët e rretheve, gjyqtarët e periferisë, të cilët ndihen të nënperfaqësuar në organin e tyre qeverisës. Kështu që ne i jemi përgjigjur këtij shqetësimi me këtë sistem kuotash dhe nënkuotash. Natyrisht që projekti ka në vetvete edhe një sistem për të garantuar cilësinë e anëtarëve të këshillave, qofshin këta anëtarë gjyqtarë apo anëtarë jogjyqtarë.

Për sa u takon anëtarëve gjyqtarë, parashikohen një sërë kriteresh ekzigjente, për shembull fakti që ata të jenë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy raundet e fundit të vlerësimit, që të mos kenë masa disiplinore në fuqi, që të kenë njëfarë vjetërsie në punë e kështu

me radhë. Jo vetëm kaq, por kërkohet që ata gjyqtarë, të cilët do të përfaqësojnë kolegët e tyre në Këshillin e Lartë Gjyqësor, përveç cilësive profesionale, të cilat përpiqemi t'i sigurojmë nëpërmjet këtij seti kriteresh ekzigjente, të kenë edhe një lloj aftësie për t'i përfaqësuar politikisht kolegët e tyre (politikisht në kuptimin e mirë të fjalës), pra në kuptimin e përcimit të shqetësimeve, të artikulimit të shqetësimeve të kolegëve dhe të mbrojtjes së tyre në këtë forum qeverisës. Prandaj kemi futur një sistem mbështetjeje nga kolegët, pra jo çdokush që dëshiron të kandidojë, mund të kandidojë. Ai person, që vendos të kandidojë, do të duhet të marrë një mbështetje nga kolegët e tij, të cilët i besojnë atij. Pra, është kombinimi i një lloji kriteri profesional me një lloj kriteri politik, që ne shpresojmë se veprimi i kombinuar i të dyve do të arrijë të çojë anëtarë cilësorë në radhët e gjyqtarëve, të paktën në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Shumë kujdes i është kushtuar edhe transparencës së procesit të përzgjedhjes deri në nominimin përfundimtar. Projekti i dedikon disa nene thirrjes për shprehjen e interesit. Ia lë këtë përgjegjësi qartësisht një autoriteti, parashikon afate për të, parashikon afate për shqyrtimin e shprehjeve të interesit, parashikon afate për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, si edhe parashikon të drejtën e atyre kandidatëve që përjashtohen për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore për t'u ankuar.

Së fundi, vjen një sistem i mirëfilltë zgjedhor dhe këtu është vendi për një zgjedhje politike që ju takon ta bëni ju. Gjatë procesit të hartimit të këtij projektligji, ndërmjet anëtarëve të grupit të ekspertëve, ka pasur një dyzim nëse detyrimin për të zgjedhur anëtarët gjyqtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor do t'ia lini një mbledhjeje të përbashkët të të gjithë gjyqtarëve apo ndoshta do të ishte më e udhës të organizoheshin tri mbledhje: një mbledhje e gjyqtarëve të Shkallës së Parë, një mbledhje e gjyqtarëve të Shkallës së Dytë dhe një mbledhje e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku secila të zgjidhte përfaqësuesit e saj. Të dyja këto zgjidhje kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Zgjidhja nëpërmjet mbledhjes së përgjithshme, e cila është ajo që ka gjetur vend në draftin që ju keni përpara ka avantazhin e zhvillimit të procesit zgjedhor në një kontekst numrash të mëdhenj, për pasojë, në njëfarë mënyrë, e zbut rrezikun e paracaktimit të fituesve. Disavantazhi po kaq evident i kësaj zgjedhjeje është fakti që populli i gjyqësorit, në qoftë se mund të përdor këtë term, gjyqtarët e Shkallës së Parë, efektivisht do të merrnin vendime se kush do t'i përfaqësonte në Këshill nga gjyqtarët e Apelit dhe nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, në një kohë që ndoshta do të ishte e udhës që çdo grup gjyqtarësh të çojë përfaqësuesit e vet, në këtë mënyrë zinxhiri i llogaridhënies është më efektiv. Pra, në qoftë se

gjqtarët e Gjykatës së Lartë çojnë njeriun e tyre në Këshillin e Lartë gjyqësor, mekanizmi llogaridhënës funksion më mirë. Kjo vlen edhe për Apelin, edhe për gjyqtarët e Shkallës së Parë. Megjithatë, ne një lloj kompromisi ndërmjet grupit të ekspertëve ju kemi paraqitur si version të parë atë me mbledhje të përgjithshme. Ju këtu duhet të bëni një zgjedhje politike. Ne ju garantojmë se të dyja sistemet i arrijnë plotësisht qëllimet. Se nga rëndon kandari më shumë, kjo i takon gjykimit tuaj. Ne mund t'ju japim edhe sigurinë se, pavarësisht se ju mund të bëni një zgjedhje të ndryshme nga ajo që është në draft, ne mund ta reflektojmë atë relativisht shpejt nga ana teknike në draft.

Për sa i takon procesit të votimit, projekti ka, gjithashtu, rregulla shumë të imta: si zhvillohet votimi, si bëhet numërimi i votave, si bëhet shpallja e rezultatit dhe ankimet. Pra, kështu mbyllet cikli i përzgjedhjes së kandidatëve gjyqtarë dhe i nominimit të tyre përfundimtar. Pastaj fillon faza e shqyrtimit të këtyre kandidatëve nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, por këtu nuk do të ndalem tani, por pak më vonë.

Një proces i ngjashëm, si ky që sapo shpjegova, për përzgjedhjen dhe nominimin e kandidatëve gjyqtarë parashikohet edhe për përzgjedhjen dhe nominimin e kandidatëve avokatë, noterë, pedagogë, pedagogë të Shkollës së Magjistraturës dhe të shoqërisë civile. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve nga shoqëria civile ka një specifikë, duke qenë se në të katra rastet e tjera proceset përzgjedhëse dhe nominimi zhvillohen në kuadrin e organizatave të këtyre grupeve të profesionistëve, pra avokatët kanë organizatën e tyre, po kështu edhe noterët. Pedagogët nuk kanë një organizatë të tyre, por ky projektligj parashikon krijimin e një mbledhjeje të posaçme të rektorëve dhe të dekanëve të institucioneve të arsimit të lartë, të cilat në këtë rast shërbejnë si organizatë që merret me përzgjedhjen dhe me nominimin e kandidatëve. Për anëtarët e shoqërisë civile kjo është thjesht e pamundur. Kemi bërë disa “shpikje” gjatë procesit të hartimit, por si përfundim e kemi lënë me kandidim të lirë. Pra, çdo kandidat nga shoqëria civile mund të kandidojë vetë dhe filtri i parë, me të cilin ballafaqohen kandidatët nga shoqëria civile, është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Për të gjithë të tjerët organizatat përfaqësuese të grupeve përkatëse bëjnë punën kryesore në përzgjedhjen dhe në nominimin e kandidatëve.

Për sa u takon përfaqësuesve të avokatisë, parashikohet një proces shumë demokratik; parashikohet një proces zgjedhor brenda çdo dhome avokatie. Çdo dhomë avokatie do të nxjerrë një numër kandidatësh në varësi të anëtarësisë së saj. Dhomat e vogla me 1 deri 50 anëtarë do të nxjerrin 1 kandidat. Dhoma e Tiranës në skajin tjetër do të nxjerrë, në mos gaboj, se nuk e mbaj

mend mirë, 10 kandidatë. Pasi të gjitha dhomat e avokatisë të nxjerrin kandidatët e tyre, do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, që do të votojë për të gjithë kandidatët që vijnë nga e gjithë Shqipëria. Ato garanci, që kanë të bëjnë me cilësinë e anëtarëve dhe me demokracinë në procesin e përzgjedhjes së tyre, të cilat i përmenda në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe gjyqtarë, janë të replikuara edhe në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve avokatë, noterë, pedagogë edhe nga shoqëria civile. Me kaq do ta mbyllja pjesën e prezantimit, që ka të bëjë me mënyrën e përzgjedhjes dhe të nominimit të kandidatëve. Në projektligj ju do të vini re që, nga ana sasiore, këtij aspekti i dedikohet një rëndësi shumë e madhe. Besoj se kjo është e kuptueshme, duke pasur parasysh se sa risi e rëndësishme është demokratizimi i procesit të përzgjedhjes dhe demokratizimi i përfaqësimit të grupeve të interesit në këshilla.

Një tjetër risi e rëndësishme tek e cila besoj se duhet të ndalem, është mënyrë e punës së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Duke pasur parasysh faktin që, sipas projektkushtetutës, këto organe tashmë janë organe permanente.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Duke pasur parasysh të gjitha përpjekjet që bëhen për të përzgjedhur njerëz me cilësi të larta profesionale dhe morale, si dhe udhëzimin e qartë të draftit, që këshillat mund të funksionojnë edhe në komisione. Projektligji parashikon krijimin e 5 komisioneve permanente, të cilat kanë fuqi vendimmarrëse. Pra, ky projektligj parashikon që pjesa dërrmuese e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pjesa dërrmuese e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë do të merren nëpër komisione. Komisionet përbëhen nga tre anëtarë secili dhe në varësi të fushës së tyre të veprimit, ata kanë ose një shumicë gjyqtarësh në përbërje, ose një shumicë jogjyqëtarësh. Për shembull, kur vjen puna tek komisioni disiplinor, që është një nga 5 komisionet permanente të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga tre anëtarët e tij, dy propozohen të jenë gjyqtarë dhe një jogjyqëtar. Po kjo përbërje, me shumicë gjyqtarësh, propozohet edhe për komisionin e etikës. Kur vjen fjala për tre komisionet e tjera, që janë: komisioni i administrimit dhe komisioni i buxhetit, komisioni i planifikimit strategjik, është edhe një i pestë që tani, nuk po e gjej, përbërja është e tillë, dhe komisioni që ka një shumicë jogjyqëtarësh, pra dy jogjyqtarë edhe një gjyqtar. Natyrisht, kjo pritet ta rrisë në një masë shumë të madhe efektivitetin e punës së këshillave. Natyrisht, jo gjithçka mbaron këtu. Projektligji parashikon një procedurë të rikonsiderimit të vendimeve, që merren nga komisionet. Pra, këshilli në mbledhjen e tij plenare,

në njëfarë mënyre, funksionon si forum ankimesh për vendimet, që merren nga komisionet. Kuptohet që në llogari të fundit vendimet e këshillit janë të ankimeshme në Gjykatën Administrative të Apelit. Pra në njëfarë mënyre, ky është cikli i vendimmarrjes dhe i ankimeve kundër vendimmarrjes. Pa dyshim që fokusi dhe orientimi këtu është, që puna të fokusohet në komisione, kjo do të rrisë efektivitetin, por edhe përgjegjshmërinë. Një nga problemet që kemi identifikuar që në fazën e strategjisë, por edhe të verifikimit, edhe të identifikimit të problemeve ka qenë mungesa e përgjegjshmërisë së anëtarëve të këshillave. Kjo, në njëfarë mase, është një sëmundje e përgjithshme për organet kolegjiale, ne përpiqemi t'i përgjigjemi kësaj përmes këtij modeli të punës me komisionet. Kjo është një risi këshillat, që besoj se ia vlen të ndalesha.

Natyrisht, ky projektligj bën edhe listimin shterues të funksioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të atij të Prokurorisë, vetëm se në njëfarë mënyre kjo është vetëm një listë, sepse mënyra sesi ushtrohen këto funksione zërthehen te ligji për statusin dhe te ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor, në njëfarë mase edhe te ligji për Shkollën e Magjistraturës, por, siç ramë dakord, do të jetë thjesht një kre i këtij ligji.

Dua të ndalem pak tek inspektori i Lartë i Drejtësisë, që të gjithë jemi koshient, që është risia më e madhe e projektit kushtetues. Projekti kushtetues kërkon një inspektor të Lartë të Drejtësisë, që është një organ monokratik dhe i centralizuar. Kështu që pa dyshim që edhe projekti shkon në këtë linjë. Megjithatë, ne jemi përpjekur ta zbusim centralizmin, që duket sikur urdhëron drafti kushtetues. Pa dyshim që draftin kushtetues kërkon një inspektor monokratik, siç kemi sot prokurorin e Përgjithshëm. Megjithatë, duke qenë dëshmitarë të faktit se centralizmi në prokurorinë shqiptare nuk ka sjellë ato rezultatet që të gjithë kemi pritur, në fazën e hartimit të ligjit ne jemi munduar që aty, këtu ta zbusim. Çfarë do të thotë? Si mund ta zbusësh një urdhërim të Kushtetutës pa e ç'bërë atë? Besoj se kemi gjetur mënyra. Pa dyshim që vendimet, në fund të fundit, do të merren nga inspektori i Përgjithshëm. Besoj se është e qartë për gjithsecilin se cili ishte objekti i veprimtarisë së inspektorit, unë nuk po ndalem këtu, ai është përgjegjës për verifikimin e ankesave, për hetimin, me nismë, të shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të këshillave dhe prokurorit të Përgjithshëm. Në projektligj ka edhe dispozita për vënien në lëvizje të punës së Inspektorit të Lartë, kush e vë në lëvizje inspektorin e Lartë. Ka disa parime themelore të veprimtarisë dhe organizimit, të cilat, në njëfarë mënyre, janë dispozita standarde. Ka një zberthim të kushteve dhe të kriterëve të emërimit që jep projekti kushtetues, një zberthim të papajtueshmërive; ka një



zberthim të procedurës për përzgjedhjen dhe emërimin e inspektorit të Lartë, pastaj ka një shpjegim të detajuar të kompetencave të inspektorit të Lartë. Këtu kemi pasur një mëdyshje të rëndësishme. Ky projekt i njeh inspektorit të Lartë të drejtën që të nxjerrë urdhra të përgjithshëm, me natyrë administrative ose procedurale për mbarëvajtjen dhe metodën e punës; për koordinimin e punës midis inspektorëve; për garantimin e kuptimit dhe të zbatimit uniform të ligjit; për përcaktimin e rregullave të etikës profesionale nga inspektorët dhe personeli administrativ dhe çdolloj çështjeje tjetër me natyrë të përgjithshme. Këtu kemi shtuar një koncept: “pasi merr mendimin e mbledhjes së inspektorëve”. Pra, ne propozojmë që të krijohet edhe një organ konsultativ pranë inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që do të ishte mbledhja e përgjithshme e inspektorëve, kjo është përpjekja jonë e parë për ta zbutur disi centralizmin e këtij.

Përpjekja e dytë vjen pak më poshtë te neni që merret me shpjegimin e detyrave të inspektorëve. Aty thuhet se, natyrisht “inspektori i Lartë është ai që firmos, në fund të fundit, vendimet e institucionit, pra është ai që firmos shkresën që i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku kërkohet shkarkimi i gjyqtarit X, është ai që firmos shkresën, e cila i dërgohet Kuvendit për të kërkuar shkarkimin e prokurorit të Përgjithshëm, por në një përpjekje të fundit për ta zbutur disi centralizmin ne themi: “Në rast se midis opinionit të inspektorit që ka hetuar çështjen dhe opinionit të Inspektorit të Lartë ka një mosmarrëveshje, atëherë vendimit të inspektorit të Lartë duhet t’i bashkëngjitet edhe projektvendimi i inspektorit të çështjes”. Pra, këto janë dy përpjekjet që kemi bërë ne për ta zbutur disi centralizmin, duke shpresuar që jemi në linjë edhe me kuptimin tuaj, por edhe me kuptimin më të gjerë të shoqërisë shqiptare në lidhje edhe me pasojat e centralizmit gjatë këtyre viteve.

Edhe diçka që duhet ta kisha thënë që në fillim, për të gjitha këto institucione të reja që krijohen nga projektkushtetuta, tashmë ky projektligj jep një regjim të plotë dhe funksional disiplinor, nuk më njerëz përtej përgjegjësisë disiplinore, për të gjithë këta: për anëtarët e këshillave, për inspektorin, madje edhe për anëtarët Këshillit të Emërimeve, në cilësinë e tyre si të tillë. Ka një listë shteruese me shkelje disiplinore, ka një organ, të cilit i besohet hetimi i këtyre shkeljeve disiplinore, ka edhe një organ të fundit, që merr vendimin për ndëshkimin e shkeljeve disiplinore. Këto janë gjithmonë të ndara. Është bërë gjithmonë një përpjekje për të krijuar një raport të shëndetshëm midis atyre që kryejnë vendimin dhe atyre që marrin vendimet

në çështjet e disiplinës. Natyrisht që nuk bëhet përjashtim as për inspektorin e Lartë të Drejtësisë, edhe për atë ka një listë shteruese me shkelje disiplinore.

Pas ndryshimeve që i janë bërë draftit kushtetues në datën 14 qershor, tani ka ndryshuar roli i hetuesit dhe roli i gjykatësit në rastet e përgjegjësisë disiplinore të inspektorit të Lartë. Në versionin më të hershëm të Kushtetutës, parashikohej që hetimi do të bëhej nga ministri i Drejtësisë dhe vendimmarrja do të bëhej nga Tribunali i Drejtësisë. Tani parashikohet që hetimi i shkeljeve disiplinore të inspektorit të Lartë të bëhet nga një komision hetimor parlamentar në përputhje me rregullat e ligjit përkatës dhe të Rregullores së Kuvendit. Më pas ky komision mund t'i propozojë Gjykatës Kushtuese shkarkimin e inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pra, ka vetëm nja sanksion për inspektorin e Lartë “Shkarkim”, nuk ka masa të tjera. Ky është një dallim i inspektorit në raport me anëtarët e këshillave. Anëtarët e këshillave mund të ndëshkohen me një mori mënyrash dhe këto mënyra janë të parashikuara në ligjin për statusin, ndërsa inspektori i Lartë mund të ndëshkohet vetëm me “Shkarkim” përmes kësaj procedure që një hibrit midis *inpeachment-it* klasik dhe një mekanizmi disiplinor klasik.

Aspekti, *inpeachment* qëndron te fakti se është parlamenti që kryen hetimin dhe aspekti i një procedure të mirë disiplinore është edhe fakti se është një gjykatë ligji që e merr vendimin.

Së fundi, dua të them pak fjalë në lidhje me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Edhe këtu ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në draftin e datës 14 qershor, që ka të bëjë me përbërjen. Kemi kaluar nga një përbërje exsofficio, ku anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ishin anëtarë për shkak të funksionit të tyre, kurse tani kalohet në një sistem përzgjedhje rastësore. Këtë rregullim e bën Kushtetuta. Projektligji, përcakton kushtet për t'u përfshirë në short. Është e vërtetë se dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtuese, një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, gjyqtar nga Apelet mund të përzgjidhen rastësisht për të qenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por aman projektligji vendos disa kushte, më saktësisht dy kushte: që ata gjyqtarë, ndaj të cilëve ka një masë disiplinore në fuqi, ose ata gjyqtarë, ndaj të cilëve ka filluar një procedim disiplinor, nuk mund të jenë pjesë e shortit. Vërtet do të hidhet short me të gjithë gjyqtarët e Apelit, për të marrë një shembull, por përpara se të hidhet shorti do të hiqen nga lista X apo Y, të cilët kanë një masë disiplinore në fuqi. Pra, këtë bën projekti, që shkon një hap më tej sesa Kushtetuta, dhe vendos disa kushte për ata që mund të përfshihen në short.

Një tjetër gjë shumë e rëndësishme që ka të bëjë me Këshillin e Emërimeve, dhe që e bën ky projektligj, është zberthimi i dy aspekteve. Subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e

Emërimeve në Drejtësi, kjo varet nga zyrtari që pritet të emërohet. Në rast se zyrtari që pritet të emërohet është gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i cili emërohet nga Presidenti, atëherë është Presidenti ai që e vë në lëvizje Këshillin e Emërimeve; në rast se është, të themi, është një anëtar i Këshillit të Lartë të Gjyqësor, që vjen nga avokatia, atëherë është kryetari i Dhomës së Avokatisë ai që e vë në lëvizje Këshillin e Emërimeve, pra ka një listë shteruese të subjekteve që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, në varësi të funksionarit, i cili pritet të emërohet.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi organizon deklarin dhe kontrollin e pasurisë së kandidatëve, po kështu Këshilli i Emërimeve në Drejtësi organizon deklarin dhe kontrollin e rekordeve penale të kandidatëve dhe, ajo që është më e rëndësishmja, bën vlerësimin e kritereve morale dhe proporcionale të kandidatëve. Ky është një nen i gjatë, i cili, në njëfarë mënyre, përpiket të shërojë një plagë të kahershme, të mënyrës sesi funksion përzgjedhja e kandidatëve për funksione të rëndësishme kushtetuese në Shqipëri, ku shpeshherë nuk jemi të qartë, se pse zgjidhet njëri dhe jo tjetri. Ka një nen në këtë projektligj që ka të bëjë me mënyrën sesi Këshilli i Emërimeve bën vlerësimin dhe peshimin e kritereve profesionale dhe morale. Aty këshilli udhëzohet që të shikojë relevancën e përvojës profesionale në raport me pozicionin për të cilin konkurrohet, kërkohet që të marrë në shqyrtim rezultatet e vlerësimit profesional dhe etik të kandidatëve, në qoftë se ka pasur të tilla; i kërkohet Këshillit të shqyrtojë aftësitë e tyre organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kur fjala është për të emëruar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo inspektorin e Lartë të Drejtësisë; i kërkohet të shikojë punimet akademike, studimet shkencore, shkrimet, ligjëratat, rezultatet gjatë studimeve në universitet, trajnimet, kurset, gjuhët e huaja, reputacionin, cilësitë morale, angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave civile. Pra, është një pjesë e ligjit edhe pse duket pak si letërsi, që është mundësia e vetme për ta orientuar punën e Këshillit të Emërimeve në drejtim të identifikimit të kandidatëve më të mirë.

Unë do ta ndalja këtu prezantimin tim, duke më kuptuar që është e pamundur të jem plotësisht shterues në prekjen e të gjitha çështjeve që trajton ky ligj, është një ligj shumë voluminoz, siç e keni vënë re, duke ia lënë radhën pyetjeve nga ana juaj.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ndërkohë, kolegët mund të përgatiten për pyetjet që mund të kenë. Dëshiroj t'ju falënderoj për punën shumë serioze që keni bërë ju në cilësinë e bashkëkryetarëve dhe gjithë grupin e ekspertëve të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtarë që janë angazhuar, ekspertët *ad-hoc* shqiptarë dhe ndërkombëtarë, të gjithë ata gjyqtarë, prokurorë, pedagogë për këto projektligje dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë me kontribute konkrete në draftimin e këtij projektligji tejet të rëndësishëm!

Përtej vlerësimeve, dëshiroj të shtroj disa pyetje për dy çështje që shpresoj të jenë edhe në vëmendjen e relatores, si edhe të stafit gjatë momentit të shqyrtimit jo vetëm në parim, por edhe nen për nen.

Pyetja e parë është e fokusuar te raporti ndërmjet pushteteve. Këtu po bëjmë fjalë për organet e qeverisjes së një pushteti, të përmbledhur po e quaj pushteti i drejtësisë, i dhënies së drejtësisë, duke qenë se kemi të përfshirë edhe gjyqësorin, edhe prokurorinë, një pushtet tejet i rëndësishëm, të cilin ne duam ta reformojmë substancialisht për t'i dhënë peshën, autoritetin dhe rolin që meriton në shoqëri edhe në raport me dy pushtetet e tjera. Parimi i balancës dhe i kontrollit ndërmjet dy pushteteve është parimi bazë themelor për një qeverisje të shëndetshme. Ajo që dua të pyes, të shtroj si pyetje, por që të jem i sigurtë duke pasur brenda edhe një lloj shqetësimi, preokupimi, është: në këtë mënyrë se si janë dhënë kompetencat, mekanizmi i funksionimit, a arrijmë ne ta kemi ndërmjet këtij pushteti, institucioneve të tij dhe dy pushteteve të tjera të jetërsuar këtë parim të rëndësishëm të balancës dhe kontrollit ndërmjet pushteteve? Në vlerësimin tim roli i ekzekutivit dhe kur them këtë gjë, kam parasysh gjithmonë ministrin e Drejtësisë, i cili në optikën time do të përmbledhet në rolin e tij me një frazë të vetme si avokati më i mirë i gjyqësorit, i drejtësisë në ekzekutiv dhe si përfaqësuesi më i drejtpërdrejtë i ekzekutivit në këtë sistem, si e kemi? A mos ka vend për ta riparë, duke respektuar të gjithë atë që është trajtuar këtu edhe në reflektim të opinionit që ka dhënë Komisioni i Venecias dhe nevojës që kemi për të mos ndikuar ekzekutivi në vendimmarrjen e gjyqtarëve dhe të prokurorëve? Pa dyshim që po, por në mënyrë indirekt edhe përmes organeve të tij, gjithashtu.

Jam dakord edhe me shqetësimin që kanë ngritur një pjesë e kolegëve të maxhorancës, por edhe në mënyrë të veçantë kolegët e opozitës për këtë çështje, sensitivitetin që kanë pasur, por kjo nuk do të na çojë që të kemi një mungesë ndërveprimi ndërmjet ekzekutivit, por edhe një marrëdhënie të shëndetshme.

Së dyti, është raporti i pushtetit me parlamentin. Unë nuk e shikoj këtë në këndvështrimin që parlamenti është mbi pushtetin gjyqësor, këto janë pushtete të barabarta, por që kjo është republikë parlamentare dhe pa dyshim që parlamenti ka një rol të veçantë, përpos faktit që një pjesë e mirë e këtyre organeve gjenerojnë nga parlamenti, përpos faktit që parlamenti ka një përgjegjësi politike para zgjedhësve, ne kemi nevojë për të pasur një lloj kontrolli edhe mbi institucionet, siç kanë të drejtën e kontrollit kushtetues dhe ligjor që të gjitha këto mbi vendimet e parlamentit apo mbi aktet e ekzekutivit. Preokupimi im është që të gjitha këto në këtë aspekt kanë vend për t'u riparë. Nuk e di se cili do të ishte komenti juaj.

Çështja e dytë që na preokupon dhe që përgjithësisht është zgjidhur mirë nga këndvështrimi im, është raporti ndërmjet institucioneve qeverisëse. Duhet të pranojmë që ne sistemin e qeverisjes nuk e kemi sot të qendëruar, as nuk e kemi pasur. Kemi pasur një organizim tjetër të gjyqësori, të prokuroria, por edhe brenda tyre, përjashto prokurorinë që ka qenë e përqendruar, e centralizuar pjesa tjetër e gjyqësorit ka qenë e shpërndarë për të mos thënë e hallakatur. Zgjidhjet e dhëna janë shumë të mira. Problemi shtrohet, në këto kushte, raportet ndërmjet tyre, ju i përkufizuat, nëse isha i vëmendshëm me një term, “nevojën për të pasur një lloj tensioni të shëndetshëm”. Dakord? Term i gjetur. Preokupimi im është që nga sa kuptoj ende nuk e kemi fort të zgjidhur, sepse përveçse këto duhet të jenë në një marrëdhënie, kanë të ndara përgjegjësitë e tyre sektoriale, kanë të nevojshme dhe një lloj bashkëpunimi. Duke vepruar brenda sistemit si trupa më vete, pa pika lidhëse, rezultojnë të na kthehen në një konflikt të përhershëm për një moment.

E dyta, kontrolli reciprok, jam shumë dakord me rolin që ka Inspektorati i Lartë i Drejtësisë mbi to, nga ana tjetër dhe për mënyrën e reagimit mbi aktet e inspektorëve diçka duhet parë.

Ajo që më shqetëson më shumë dhe dëshiroj të bëj një pyetje, në vlerësimin tuaj sa i kemi dhënë zgjidhje ne, pas një sëmundjeje të vjetër që kemi në sistem, korporatizmit? Te kjo formulë që kemi, që në tërësi si zgjidhje është shumë efektive, brenda elementeve të funksionimit të saj, a kemi risk? Cili është risku që mund të kemi për ta ripasur, për t'u rigjallëruar kjo sëmundje siç është korporatizmi, që është mjaft e dëmshme edhe në vlerësimin tuaj, në analizat që keni bërë? Si dhe sa mund ta bëjmë më transparente të gjithë këtë proces, në mënyrë që edhe presioni i publikut, por edhe presioni i pushteteve të tjera të jenë më prezentë

dhe të jetë më e ekspozuar veprimtaria e gjithë këtyre institucioneve qeverisëse, përfshirë edhe dy këshillat, në mënyrë të veçantë edhe Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë?

**Genti Ibrahimi** – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Pa dyshim këto janë shqetësime shumë legjitime. Në një masë përcaktuese do të thosha se zgjidhjet që jepen nga ky projektligj e kanë origjinën te drafti kushtetues, megjithatë kjo nuk është një arsye për të thënë që nëse gabimi është bërë atje, ne nuk mund të bëjmë një tjetër, vetëm se ta replikojmë atë. Kurrsesi jo, siç u përpoqa të shpjegoj pak më parë në fazën e hartimit të ligjeve jemi përpjekur të zbusim efektin e zgjidhjeve kushtetuese, kur kemi gjykuar se ato zgjidhje janë të tilla që mund të shpien në teprime, në njërën anë apo në tjetrën. Ishte rasti i inspektorit të Lartë kur projekti kushtetues urdhëron një organ monokratik të centralizuar. Ne kemi gjetur disa zgjidhje teknike, që shpresojmë se e zbusin këtë gjë. Kjo vlen për të gjitha çështjet, pavarësisht se çështja e raportit midis pushteteve merr zgjidhjen kryesisht në draftin kushtetues, edhe në nivelin e hartimit të ligjit ka hapësirë për zgjidhje, të cilat ose i zbusin ato zgjidhje që mund të duken problematike në draftin kushtetues, ose forcojnë efektin e atyre zgjidhjeve që janë të mirëpritura në draftin kushtetues.

Për sa i përket çështjes së raportit midis pushteteve, vërtet drafti kushtetues edhe ky projektligj shkon në një masë të madhe në drejtim të garantimit të një varësie më të madhe të organeve të qeverisje së gjyqësorit, por brenda këtij konstelacioni të organeve të qeverisjes së gjyqësorit ka ndarje të kompetencave dhe të pushteteve.

Ju kujtoj që sot ne kemi të përqendruar në një dorë pushtetin për të inspektuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe të prokurorëve me pushtetin për t'i ndëshkuar ato. Ky projekt bazuar në projektin kushtetues bën një ndarje të madhe. Kjo është një ndarje shumë e rëndësishme, besoj unë, nëse do të më thoshin që vëri gishtin një ose dy-tre ndryshimeve më të rëndësishme në projektin kushtetues dhe në këtë projekt, unë do të thosha që ndarja e funksionit të inspektimit me funksionin e gjykimit për shkeljet e dyshuara disiplinore është me të vërtetë revolucionare. Ne kemi qenë të gjithë koshientë të asaj plaje afatgjatë që ka qenë dyzimi i kompetencave inspektuese midis ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një dyzim, i cili në një farë mënyre e ka lënë pa përgjegjësi këtë funksion kaq të rëndësishëm. Ne jo vetëm që e ndajmë, por i japim një status kushtetues zyrtarit, të cilit i besohet ky funksion i rëndësishëm. Kjo është një ndërhyrje e rëndësishme: ndarja midis inspektimit dhe gjykimit. Në përbërjen e këshillave, në mbledhjen e këshillave parashikohet prania e ministrit të

Drejtësisë. Ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të cilat diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe me buxhetin e sistemit gjyqësor. Pra, një zë përfaqësues i ekzekutivit në organin vendimmarrës të qeverisjes së gjyqësorit, kur çështjet që diskutohen janë të tilla, janë të rëndësishme për qeverinë dhe për të cilat qeveria duhet të ketë një zë në kapitull. Kini parasysh mënyrën sesi funksionon, sesi ushtrohen kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor në raport me caktimin e hartës gjyqësore në raport me caktimin e buxhetit gjyqësor. Këto i diskutuam në kuadrin e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”. Në të dyja rastet ka një përfshirje të ekzekutivit ose të pushtetit politik qoftë në përcaktimin e hartës gjyqësore, zgjedhjet që u shtruan në këtë tryezë në këtë aspekt ishin ose Presidenti i Republikës ose Kuvendi me një ligj, sidoqoftë përfshirja e pjesës politike të pushtetit në marrjen e këtij vendimi të rëndësishëm është e qartë, sipas mendimit tim e mjaftueshme, përfshirja është akoma më e qartë në rastin e caktimit të buxhetit të gjyqësorit, në fund të fundit vendimmarrja finale i përket pushtetit politik, është transferuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në adresë të qeverisë edhe vendimmarrja në lidhje me sistemin për teknologjinë e informacionit që do të përdoret për menaxhimin e çështjeve gjyqësore.

Të gjitha këto, sipas mendimit tim janë disa pyka të rëndësishme, të cilat i japin mundësi pushtetit ekzekutiv, të politikës në përgjithësi, të thotë të vetën aty ku është vendi për ta thënë. Pak më tutje do të përmendja rolin që ka politika në disiplinimin e inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky i fundit është një institucion shumë i fuqishëm, i cili vë në lëvizje procedurën disiplinore për funksionarët më të lartë të drejtësisë. Ky nga ana e tij mund të disiplinohet jo me vendimin e politikës, por me nismën e politikës. Në rast se politika vendos që për një nga ato arsye që parashikohen në nenin që jep shkeljet disiplinore të inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendi për të filluar një hetim parlamentar, politika e bën këtë, një hetim parlamentar, ka disavantazhe, por ka edhe shumë avantazhe, ka një publicitet të paparë. Nuk është kollaj për Gjykatën Kushtetuese të sfidojë në mënyrë të paarsyeshme përfundimet e një komisioni parlamentar. Pra, nëse një komision parlamentar punon siç duhet dhe arrin të evidentojë shkeljet e inspektorit, do të jetë e vështirë për Gjykatën Kushtetuese t’i neglizhojë gjetjet e komisionit parlamentar. Mendoj se kjo është një tjetër pykë shumë e rëndësishme që i jep dorë politikës dhe ekzekutivit për të pasur një rol në organizimin e drejtësisë.

Për sa i përket bashkëpunimit midis këshillave, midis organeve të qeverisjes, kjo është e vërtetë, bashkëpunimi midis inspektorit dhe këshillave nuk mund të jetë veçse procedural. Siç është bashkëpunimi, nëse mund të përdor këtë term midis prokurorit dhe gjykatësit, ku prokurori ngre kauzën dhe përpiqet të bindë gjyqtarin për drejtësinë e saj, i tillë është edhe bashkëpunimi midis inspektorit dhe këshillave. Ky i fundit ngre akuzën dhe përpiqet të bindë organet vendimmarrëse, këshillat ose Kuvendin në rastin e prokurorit të Përgjithshëm, që subjekti në fjalë duhet të disiplinohet.

Për sa i përket bashkëpunimit midis Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, projektligji parashikon mundësinë e organizimit të mbledhjeve të përbashkëta për shkëmbimin e përvojave dhe për unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Së fundi, për sa i përket shqetësimit të korporatizmit ka disa zgjidhje që e kanë origjinën në një masë të madhe në draftin kushtetues. Në fund të fundit kryesimi, përbërja e organeve qeverisëse, e dy këshillave është e balancuar me gjyqtarë, me magjistratë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është e thënë të jetë magjistrat, mund të jetë i tillë, por mund të mos jetë. Këto besoj se janë dy garanci. Kryesimi i këshillave në çdo rast i besohet jo magjistratëve.

Një moment delikat që mund të vërehet nga dikush është, unë thashë pak më parë që vendimet do të merren kryesisht në nivel komisionesh brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor. Unë thashë se Komisioni Disiplinor duke pasur parasysh se sa delikate është kjo çështje për pavarësinë e gjyqësorit, duhet të ketë një shumicë gjyqtarësh, nga tre anëtarë, dy gjyqtarë. Megjithatë, ky është një terren fertil, e pranoj për korporatizëm, gjithsesi këto vendime mund të ankimohen pastaj dhe të shqyrtohen nga dega plenare e këshillit, ku, pavarësisht se shumica mbetet gjithmonë e gjyqtarëve, besoj se zbutet pak efekti i dominimit për shkak të faktit që kemi të bëjmë me numra më të mëdhenj dhe është gjithmonë mundësia e ankimit në gjykatë.

Ajo çka është më e rëndësishme është që ky projektligj detajon kërkesën e Kushtetutës për transparencë në punën e këtyre organeve. Pra, ne besojmë se transparenca është një antidot shumë i rëndësishëm ende për antikorporatizmin.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, faleminderit për përgjigjet tuaja!

Ka pyetje? Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Me thënë të drejtën, nuk kam ndonjë vërejtje shumë të veçantë, por për sa i takon, në radhë të parë, mënyrës sesi te Këshilli i Emërimeve, meqenëse është një pikë delikate kjo që në përzgjedhjen e kandidatëve njërën, tjetrën, që, në fund të fundit, çështja, pavarësisht se



ngatërrohet, reduktohet pikërisht në çështjen se çfarë kandidatësh zgjedhim, unë mendoj në mënyrë të veçantë se, do të vijmë edhe nen për nen dhe do ta themi, shumë kategorizime që gjenden këtu në ligj janë larg të qenit kritere objektive dhe shumë larg të qenit të mundshme, për të siguruar një vlerësim objektiv.

Krijimi i kapitujve të tillë, si renditjen në bazë të meritave të tyre morale, me thënë të drejtën, pandehja se e kishim lënë pas që në '90-ën, por u rikthye prapë kjo punë, edhe në bazë të shumë meritave të tjera të karakterit shkencor. Sinqerisht, në disa raste më duket sikur ne zgjedhim shëf departamentesh në universitet dhe jo inspektorë, a ku e di unë se çfarë, se përderisa arrijmë që Këshilli i Emërimeve do të kërkojë apo të verifikojë si e dinë ose jo gjuhën e huaj, tani unë të them të drejtën për këto dispozita, po jua them që më përpara, edhe kur të vijë nen për nen, absolutisht do të votoj kundër dhe do të votoj pro me shumë dëshirë kur të shikoj kritere objektive, të cilat vërtet na e heqin nga subjektivizmi dhe nuk na e bëjnë këtë një proces përzgjedhjeje akademike, por një përzgjedhje të vërtetë për funksionet që ata marrin. Madje, unë besoj që ligjit duhet t'ia kursejmë, me shumë ekzigjencë, të tilla kategorizime sipërfaqësore.

Së dyti, lidhur me shpjegimet që kanë lidhje me pyetjen dhe çështjen që zoti Xhafaj ngriti me të drejtë, vazhdoj t'i mbetem bindjes se ka një çekuilibër problematik lidhur me raportin ndërmjet pushteteve. Shqipëria ka pushtete të ndara dhe pushtete që ndërveprojnë, nuk ka pushtete imune dhe pushtete të atakueshme, pra një pushtet gjyqësor imun, i cili mund ta zhvillojë në forma të reja dhe më të sofistikuar korporatizmin e tij, dhe pushtetet e tjera, siç është ai ekzekutiv, po të doni edhe legjislativ, të cilët janë nën atak, duke harruar që këto pushtete të tjera prodhojnë edhe pushtetin gjyqësor dhe kanë përgjegjësi të rëndësishme para publikut, i cili i zgjedh si përfaqësues të tyre.

Ndaj, do të kisha një sugjerim: për sa i takon në mënyrë të veçantë nenit ku përcaktohet roli i ministrit të Drejtësisë, me shumë dashamirësi mund ta hiqni fare atë nen, mund të thoni që ministri i Drejtësisë nuk ka asnjë rol në sistemin gjyqësor (do të kishte qenë një përcaktor shumë i ndershëm dhe unë do ta mbështesja). Është më e drejtë kjo sesa roli i ministrit që vjen atje kur diskutohen çështjet e buxhetit, pra është një njeri që vjen me një qese me para atje në mbledhjen e Këshillit Gjyqësor dhe disa i thonë: "Na jep disa nga ato lekët e tua, që të financojmë sistemin" dhe pastaj "që nga ky moment dil përjashta" besoj se një rol i tillë nuk i hyn në punë kurrkujt. Ai duhet të ketë një rol dhe një bashkëpunim funksional, në bazë të përgjegjësisë të mëdha politike që ka. Ne harrojmë që ministri është një figurë kushtetuese, sepse dëgjova këtu që iu dha roli në

këtë proces i inspektorit, që është një figurë kushtetuese, duke harruar se ministri është vetë apo ka qenë vetë një figurë kushtetuese edhe në çështjet e përcjelljes së ankimeve.

Në këtë pikë, i ftoj kolegët që të jemi të qartë dhe të prerë në këtë çështje. Në qoftë se mendojmë që të gjithë së bashku të votojmë për një rol të tillë qesharak, inekzistent... Ka vendime të forta dhe nuk ka asgjë të keqe, themi se nuk përcaktohet asnjë rol i ministrit të Drejtësisë në sistemin që po ngremë dhe kjo nuk ka asgjë të keqe, por edhe kjo është kurajë. A është kurajë, a është marrëzi, hajdeni ta ndajmë. Megjithatë, kurajë është edhe kjo. Marrëzinë dhe kurajën një gjë e vogël i ndan, dhe ta themi. Por ama që të bëhemi të ndërgjegjshëm që ne me vetëdije të plotë po vëmë pozicione të tilla qesharake dhe i krijojmë publikut, japim mesazhin më negativ nga të gjithë, se ne jemi një maxhorancë që ngremë ekzekutivin, e votëbesojmë dhe vetëm tek ai nuk kemi asnjë gramë besimi, ruhem nga ky ekzekutivi si djalli nga temjani, sepse është ekzekutivi që mund ta prishë gjyqësorin apo ta infektojë atë, unë nuk jam nga ata që e votëbesoj ekzekutivin dhe pastaj dyshoj ose e stigmatizoj atë.

Kështu që edhe në këtë pikë mendoj se do të duhej patjetër të kishim një pozicion të qartë edhe si komision. Këtu nuk besoj se duhet të jemi viktimë e asnjë lloj kompleksi, as të lojërave taktike që ka bërë opozita, as të lojërave të çdo forme tjetër.

Gjithashtu, edhe për sa i takon, po i kthehem edhe një herë tjetër çështjes së emërimeve, ju e shikoni, dhe besoj se ky është një sugjerim edhe për reflektim, në rast se ka reflektim gjithmonë, pasi kam vënë re që reflektimet janë shumë të vështira, arrihet deri këtu që inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi merr mendimin e Komisionit të Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si e zgjedh inspektorin? Bazuar në rezultate dhe studime universitare, punë akademiko-shkencore, njeh një nga gjuhët e huaja dhe rezultatet e përvojës profesionale. Merrni shikoni që të gjitha kërkesat që duhen për të emëruar një shef departamenti shkencor, ku të doni në universitet, ka të njëjtat kriteret. Në rafshim në këto nivele, besoj që jemi larg të ndërtuarit së një drejtësie profesionale, por që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me performancën e matshme të punës që bën secili nga këto personazhe.

Kam edhe një konsideratë të fundit dhe nuk dua t'ju marr më kohë.

Ne kemi diskutuar dhe diskutojmë gjatë, duke fetishizuar decentralizimin. Po ju them se centralizimi dhe decentralizimi kanë qenë dy koncepte, të cilat e kanë udhëhequr, në një mënyrë a një tjetër, edhe botën, edhe sistemet sipas mënyrës së tyre.

Sëmundje e madhe e botës nuk kanë qenë centralizimi ose decentralizimi, por ka qenë funksionimi i tyre korrekt dhe në përputhje me ligjin ose jokorrekt dhe në përputhje me ligjin. Pasi kemi parë sisteme të decentralizuara, të cilat kanë decentralizuar epideminë e papërgjegjshmërisë dhe të abuzimit, kemi parë edhe sisteme të centralizuara, ku është abuzuar njësoj me këtë gjë.

Në emër të demokratizimit të sistemit, që është një revolucionarizim i sistemit, ndonëse vetë nuk jam partizan i revolucioneve, jam kundër tyre, do të thosha që ky raport delikat për një decentralizim shumë të hapur, thuajse të pakontrolluar e pa kufi, të jeni të bindur se, po ua them kolegëve këtu, edhe sot që jemi në politikë, edhe nesër kur nuk do të jemi në politikë, do të shikoni që do të ketë një proces krejtësisht të pakontrolluar dhe ky decentralizim eksziv, i tejmasës do ta bëjë edhe më të pakontrolluar situatën sesa sot.

Demokratizimi i thellë dhe decentralizimet e mëdha do të thotë që janë të lidhura edhe me kualitete të mëdha të klasës dhe të lëndës së parë të gjyqtarëve, a ku e di unë se çfarë, magjistratëve, juristëve e të tjerë.

Besoj që ka një mungesë realizmi në këtë çështje, nuk kemi një traditë kaq të shkëlqyer neve, as qindravjeçare, as dhjetëvjeçare, pasi tradita jonë e pluralizmit daton vonë, që ta kemi krijuar një mjedis të tillë, të një integriteti kaq të lartë profesional dhe të gjithë komponentëve të tjerë, në mungesë të të cilit ne të delegojmë edhe një decentralizim kaq të madh, i cili do të ishte së bashku me të edhe një abuzim i mundshëm jo i vogël, por i pakontrolluar, i decentralizuar, i kapilarizuar dhe në sistem.

Të centralizuar, duke e mbajtur në një atak shumë të fortë publik, politik e të tjerë, dhe ne jemi përplasur me probleme të tilla. Po i decentralizuar, lind pyetja? Vlerësimi i bërë është vlerësim realist për të marrë një zgjidhje të tillë, apo ka qenë vlerësim akademik ose, thënë më thjesht, *ex catedra*? Druaj se është ky i dyti.

Në ligj është momenti që ne të jemi të kujdesshëm në këtë punë dhe të mos shtyhemi nga ide, të cilat mund të jenë shumë të mira, nuk jam kundër ideve, por mund të kenë edhe elemente të utopisë lidhur me realitetin ku jetojmë dhe më tutje pastaj do të na bëjë që ne të mallkojmë duart tona që ngrihen lart për të votuar për sisteme të tilla, të cilat pastaj nuk i kontrollojmë dot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Keni koment?

**Gent Ibrahimi** – Është e përgjithshme, sepse edhe çështjet u shtruan më shumë si probleme sesa si pyetje, kështu që unë nuk kam ndër mend të kthej përgjigje. Por e pranoj komentit e zotit Vasili, që po t’i hedhësh një sy nenit përkatës për mënyrën sesi Këshilli i Emërimeve në Drejtësi bën renditjen e kandidatëve është shumë e detajuar. Ndonjë gjë edhe mund të mos ishte aty, mund t’i lihej një rregullimi nënligjor nga vetë Këshilli për Emërimet në Drejtësi. Por ama duhet të bëj këtu një dallim midis verifikimit të kushteve ligjore dhe verifikimit të tri kriterëve profesionale dhe morale. Kushtet ligjore janë kategori të gjera: kaq vite përvojë, kaq moshë, kjo e shkuar profesionale. Këto shkruhen lehtësisht dhe verifikimi i tyre është po kaq i thjeshtë. Kur vjen puna për të ndarë shapin nga sheqeri, e rëndësishme është të arrish t’u japësh peshën e duhur kriterëve profesionale dhe morale. Këtu puna vetiu bëhet e imët dhe ndoshta gjuha nuk duket fort e denjë për një ligj. Por, unë mendoj se në këtë pikë është më e rëndësishme të arrijmë të japim një udhëheqje të mirë për ata që do t’i kryejnë këto punë sesa të shqetësohemi, le të themi, për formën e ligjit.

Megjithatë, disa nga këto gjëra, që për momentin janë këtu në ligj, mund të transferohen në një akt nënligjor, që mund ta miratojë vetë Këshilli për Emërimet në Drejtësi. Përpjekja jonë këtu ka qenë e qartë: sa më shumë udhëheqje për anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe sa më shumë përgjegjësi për ta që kur ata të thonë: “Genti dhe jo Etilda”, ose e kundërta, të kenë mënyrën për ta shpjeguar këtë, pra pse Genti dhe jo Etilda.

Duke iu referuar këtyre kategorive, këtyre vlerësimeve të cilat aftohen, urdhërohen t’i bëhen sipas ligjit, besoj se është më e thjeshtë për ata, në radhë të parë, por edhe për ne të gjithë të tjerët që monitorojmë punën e tyre.

Ekulibri midis pushteteve është çështje e madhe.

Siç e thashë edhe në përgjigjet e komenteve të zotit Xhafaj, kjo është një çështje që duhet diskutuar më shumë në nivelin e draftit kushtetues dhe vetëm pjesërisht në nivelin e këtij draftligji. Nëse mund të hiqet dispozita që flet për rolin e ministrit në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, edhe mund të hiqet, se ajo në vetvete nuk ka ndonjë peshë të madhe, por e kombinuar me rolin e parlamentit në caktimin e hartës gjyqësore dhe në caktimin e buxhetit gjyqësor, besoj që nuk është e pakonsiderueshme.

Për sa i përket diskutimit tuaj në lidhje me decentralizimin përkundërt centralizimit, është ndoshta më i përshtatshëm për t’u bërë në kuadrin e diskutimeve për projektligjin “Për

prokurorinë”, pasi atje diskutohet zgjedhja dhe zgjedhja e madhe, kurse këtu në rastin e këtij projektligji, në qoftë se vjen ndonjë rrezik, vjen nga centralizmi i pushtetit të inspektorit të Lartë.

Pa dyshim që ne mund të shkruanim këtu edhe për një zbrërthim të një institucioni 100% centralist, kemi parë dhe ka të tillë, nuk është problem, por mënyra sesi është zbrërthyer këtu roli dhe funksioni i inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk e zhbën centralizmin e këtij institucioni, sepse po ta kishim bërë këtë, do të kishim bërë një projektligj antikushtetues. Ne thjesht gjejmë disa mekanizma proceduralë sesi ta ekspozojmë keqbërjen eventuale nga inspektori i Lartë. Kaq! Ai bën ç’ të dojë, por ama ne thjesht përpiqemi që kur të bëjë gjënë e keqe, kjo të jetë ekspozuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Petrit Vasili** – Me thënë të drejtën, jam i mrekulluar vërtet që propozimi im, që sigurisht ishte sarkazëm, nuk ishte absolutisht propozim i tillë, u pranua me kaq lehtësi, që roli i ministrit, që nuk është rol i tij, por është raporti i ekzekutivit, pra është i një pushteti me sistemin, lehtësisht edhe mund t’u hiqërka!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Thënë e gjitha kjo, mendoja se lehtësia për ta trajtuar në këtë mënyrë deri tani ishte një çështje konceptuale, kurse tani mendoj që është një qëndrim i motivuar. Nga se nuk e gjej dot, por është qëndrim i motivuar, e para.

E dyta, nuk besoj se me kthimin e ekzekutivit në noterin e gjyqësorit të jenë të qetë kolegët e mi. Po qenë të qetë, unë jam shumë i lumtur që jam një minorancë absolute këtu dhe kjo nuk më shqetëson fare, por kthimi në noter, dhe këtë e them me bindje të plotë, besoj që na kthen në... Sigurisht, ne kemi qenë edhe në të shkuarën fanarë të zgjidhjeve të mëdha. Ne nuk kemi pasur fare ministër Drejtësie para viteve ’90, shumë mirë, dhe tani na bën që të kemi ministrin e Drejtësisë, pra qeverinë shqiptare, në raport me drejtësinë, pa e tepruar, më qesharaken që mund të kemi. Çdo ministër Drejtësie, kushdo qoftë, pavarësisht nga ngjyra politike, në çdo aktivitet që do të ulet me homologët e tij, kudo që të shkojë në Europë, do të kuptojë që peshon shumë lehtë dhe këta të tjerët peshojnë shumë në raport me popullin që i zgjedh, me popullin që i njeh dhe me popullin, i cili e njeh derën e ministrisë, në Shqipëri po e po... Besoj që asnjë nga anëtarët e grupit të ekspertëve nuk do të ketë qenë ndonjëherë atje në Ministrinë e Drejtësisë, që të shikojë sesa qindra njerëz shkojnë paraqesin probleme e halle, se kjo është Shqipëria jonë, nuk është Shqipëri as angleze, as norvegjeze, as suedeze. Kur të bëhet e

tillë, të gjithë do të kemi qenë shumë të lumtur, unë e Fatmiri nuk besoj se do të jetojmë në atë ditë, se nuk kemi moshë. Thënë e gjithë kjo, lënia e publikut pa gojë, pa instrument, pa gjymtyrë, pa rrugë komunikimi, jo marrje vendimi, se kjo e fundit është atribut absolut i pushtetit gjyqësor, po ju them edhe një herë tjetër me shumë dashamirësi: kjo na çon në propozime jo realiste, në propozime tërësisht *ex cathedra*.

Unë merrem me politikë, jam marrë gjerësisht në jetën time me veprimtari shkencore, por i kam ndarë mirë se cila është ajo që ka të bëjë me mjedisin shqiptar dhe se cila ka të bëjë me katedrën apo departamentin shkencor, ku punoja. Meqenëse është e tillë, unë e shoh se nga komisioni i ekspertëve nuk ka ndonjë mundësi absolute reflektimi. Kolegët nëse do të kenë ndonjë reflektim apo ndonjë formulim të ri, do të jenë të mirëpritur. Në rast se do të kenë përcaktime të tilla edhe më tej për këto dispozita, unë do të shprehem absolutisht kundër, sepse nuk mund të bëhem pjesë e fiktivitetit në këtë pikë. Nuk është se po e them sot, por e kam thënë në mënyrë të përsëritur, me shpresë që do të kishte një iluminim për këtë pikë. Më pas kur të vijë radha për secilën dispozitë, edhe këtu, edhe në sallë do të përpiqemi që me votë të tërheqim vëmendjen që diçka negative po ndodh.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Kush ka ndonjë gjë tjetër?

Urdhëroni, zoti Muçmataj!

**Vexhi Muçmataj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke i falënderuar ekspertët për punën, për projektligjin e paraqitur, kisha një merak për përbërjen e këtyre institucioneve të reja që krijohen në sistemin e drejtësisë, për raportin e përbërjes. Me sa del nga projektligji, përbërja është në favor të gjykatësve dhe të prokurorëve që zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme. Mendoj se ky është një konflikt i hapur interesi. Pyetja ime është: A ndikon kjo në të ardhmen për t'i hapur rrugë subjektivizmit për favore miqësore apo shoqërore të këtyre institucioneve ndaj gjykatësve që do të promovohen apo do të ngrihen nesër në detyrë, do të transferohen apo do të merren masa disiplinore etj.?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Gent Ibrahimi** – Çështja e përbërjes së institucioneve të qeverisjes është padyshim themelore, se aty fillon gjithçka: e mira dhe e keqja, mirëqeverisja e gjyqësorit, korporatizmi, eficienta ose e kundërta e saj. Kjo ka qenë një çështje që është diskutuar shumë në kuadër të procesit për hartimin e draftit kushtetues. Ne këtu kemi përfituar më shumë se në çdo aspekt

tjetër, nga asistenca e Komisionit të Venecias. Me sa duket shumica e magistratëve në këto institucione është një standard. I vetmi rast në të gjithë Europën, ku ka barazim numrash midis magistratëve dhe jo magistratëve është Mali i Zi. Në atë rast Komisioni i Venecias e ka kapërdirë me shumë vështirësi si të pranueshme këtë zgjidhje. Pjesa më e madhe e vendeve që kanë këshilla gjyqësore me përbërje mikse, gjithmonë magistratët janë në shumicë, por në gjithmonë përpiqemi ta zbusim këtë në disa mënyra. Një mënyrë është ajo që këta magistratë për 5 vjet denatyrohen në një farë mënyre, sepse nga gjyqtarë shndërohen në burokratë. Për 5 vjet gjyqtarit do t'i duhet të merret me çështje administrative, me shqyrtimin e çështjeve disiplinore të kolegëve, me vlerësimin e performancës së tyre, me planifikimin strategjik, me buxhetin e gjyqësorit dhe ky është një denatyrim i shëndetshëm, sepse në këto 5 vjet ai është gjithmonë e më pak gjyqtar dhe gjithmonë e më shumë administrator. Në këtë drejtim besoj se ndikon edhe bashkëjetesa e tij me jogjyqtarët ose me joprokurorët, për një periudhë 5-vjeçare (në rastin e KLP-së). Pra, ky është kontributi i parë në drejtim të zbutjes së rrezikut që shihni ju, që vendimmarrja të diktohet nga njerëzit, të cilët duhet të jenë objekt i rregullimit të tyre.

Kryesimi i këtyre organeve në fund të fundit, u besohet jomagjistratëve dhe ky është një kontribut tjetër i rëndësishëm në drejtim të zbutjes së rrezikut të korporatizimit dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, është një strukturë rregullash procedurale për marrjen e vendimeve, që i bën vendimet gjithmonë të diskutueshme, të debatueshme, të kontestueshme eventualisht dhe çfarë është më e rëndësishme, ato gjithmonë lënë gjurmë dhe janë në sytë e opinionit publik. Pra, padyshim, rreziku që një shumicë gjyqtarësh apo prokurorësh në këshillat përkatëse ekziston, që këta ta devijojnë, si të thuash, drejtimin e këshillave në drejtim të vetëshërbimit të klasës së gjyqtarëve apo të prokurorëve, rreziku ekziston, por aty janë hedhur të gjitha zgjidhjet e mundshme procedurale dhe teknike, të cilat shpresojmë, se do t'ia dalin ta kufizojnë këtë rrezik.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Besoj se edhe zoti Muçmataj është mirësquaruar me këtë përgjigje.

Kush ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ibrahim për projektligjin!

Unë ndaj të njëjtin mendim me zotin Xhafaj që projektligji është i ri, i rëndësishëm me të gjithë kompleksitetin dhe sensibilitetin që kanë çështjet e veçanta të tij, të paktën ky është një ligj i shkruar mirë dhe i detajuar, që lë shumë pak mundësi për keqinterpretime apo për përgatitjen e akteve nënligjore, të cilat mund të prishin thelbin e ligjit. Duke ruajtur të drejtën për të bërë pyetje specifike gjatë diskutimet nen për nen, unë kam një pyetje lidhur me modelet e përdorura: Cilat kanë qenë modelet e ofruara në kompetencat që i keni dhënë këshillave dhe inspektorit të këshillit të emërimeve (përveç Kushtetutës nga e cila buron ky ligj)?

E dyta, kam konstatuar që ju jeni shprehur, se në 2 vende grupi i punës ka pasur mendime të ndryshme. A mund të kemi një listë të çështjeve për të cilat ka pasur debate të gjata apo keni ndarë mendime të ndryshme (përveç të dy çështjeve që janë dhënë në *footnote*)?

Çështja tjetër, lidhet me komisionet e zgjedhjes së anëtarëve jogjyqtarë dhe joprokurorë. Jam dakord që të ketë qartësi, saktësi, proces votimi transparencë, rregulla dhe gjithçka tjetër, por unë shoh formula të ndryshme në përbërjen e atyre që menaxhojnë procesin e votimit, pra të komisione të ndryshme për pedagogët e magistraturës, fakulteteve të drejtësisë, në avokati, në noteri, diku keni njerëz të zgjedhur me short, diku keni drejtuesit kryesorë (kryetari, zëvendëskryetari apo një anëtar i zgjedhur me short). Cilat janë arsyet që i keni bërë këto procese? Po shoh edhe afate të ndryshme të fillimit të procesit, të njoftimit të vakancës që krijohet. A ka ndonjë arsye, keni ndonjë argument apo është thjesht nga fakti që njëra procedurë është pak më e gjatë?

Kam edhe një pyetje të zgjedhja: lexova me vëmendje pjesën e zgjedhjes së përfaqësuesve nga fakultetet e drejtësisë dhe të shoqërisë civile. Ishte sqaruar në detaj çdo hallkë, por nuk e di, pa dashur të paragjykoj fakultetet e drejtësisë publike apo private, mënyra si është trajtuar, është totalisht në favor të fakulteteve private për disa arsye objektive që nuk varen nga ju: për numrin më të madh të tyre, për numrin më të madh të rektorëve dhe të dekanëve të fakulteteve private, të cilët do të jenë te bordi që do të votojnë dhe e treta, për shkak të faktit që ne kemi një kontroll shumë më të fortë të fakultetet publike dhe në kuadër të reformës së arsimit të lartë, departamentet ose fakultetet jashtë Tiranës, nuk kanë fakultet juridik, por kanë departament juridik. Pra, fakultet juridik është vetëm te Universiteti Publik i Tiranës. Vota e rektorit dhe e dekanit të këtij universiteti është në minorancë, në krahasim me votat që kanë gjithë dekanët dhe rektorët e fakulteteve private.



Nga ana tjetër, duke njohur nga brenda arsimin e lartë juridik, ne kemi një problem tjetër që nuk e di sa është diskutuar në grupin tuaj: ju thoni që do të përzgjidhen vetëm pedagogë të brendshëm. A e dini ju që ka shumë pedagogë në fakultetet private që janë pedagogë të brendshëm në letër, por që realisht janë pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë së Tiranës dhe mund të ndodhë që t'i bjerë të votojë i njëjti person edhe si pedagog i fakultetit publik, edhe si pedagog i fakultetit privat, pra të ketë dy vota? Si mund të shmangen këto probleme?

Gjithashtu, pse keni arritur që në përzgjedhjen e këtyre kandidatëve (cili ka qenë debati, fryma e diskutimit në grup, në konsultime), që një përfaqësues duhet të jetë nga fakultetet e drejtësisë publike dhe një përfaqësues duhet të jetë nga fakulteti privat? Këto janë të veçanta, me lista, apo do t'i zgjedhë mbledhja e rektorëve dhe e dekanëve? Nëse do t'i zgjedhë mbledhja e rektorëve dhe e dekanëve, të jeni të bindur që Fakulteti i Drejtësisë së universitetit publik ka mundësi të humbasë, megjithëse ka vjetërsinë, ekspertizën dhe kapacitetet, sepse ka vetëm 2 vota, në morinë e 16-17 votave sa mund të jenë ose më shumë.

Nga ana tjetër, a do të mbahet në konsideratë që një pjesë e fakulteteve nuk janë të akredituara? Pra, ne akoma nuk i dimë kapacitetet. Se nuk është kryer akoma procesi i akreditimit.

Të gjitha këto pyetje më lindën për shkak të një sqarimi që ju keni lënë në ligj, për një diskutim, ku mund të jenë përfshirë pedagogët, stafi, lektorët e fakultetit të drejtësisë së universitetit publik. Nuk e di pse na e keni lënë ne të përzgjedhim, por unë do të doja që në cilësinë e relatores, para se të shprehja opinionin gjatë diskutimit nën për nën, të kisha më shumë informacion.

Gjithashtu, më tërheq vëmendjen edhe një çështje tjetër, lidhur me raportet e Këshillit të Lartë të Emërimeve me ILDKPI-në. E kam edhe për këtë ligj, edhe për ligjin që flet për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku shpesh thuhet shpesh që Këshilli i Lartë i Emërimeve apo Këshilli i Lartë Gjyqësor bën verifikimin e pasurisë. Ndërkohë ne kemi ILDKPI-në, që bën verifikimin e pasurisë dhe nuk shoh mënyrën e bashkëpunimit midis Këshillit të Lartë të Emërimeve dhe ILDKPI-së, KLGJ-së dhe KLP-së. Thjesht që ILDKPI-ja do të vërë letrat në dispozicion dhe do të hetojë Këshilli i Lartë i Emërimeve? Mua më krijohet përshtypja sikur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më falni!

Gjithashtu, lexoj me vëmendje fundin e ligjit, pjesën tranzitore, sidomos nenin e krijimit të këshillit të përkohshëm të emërimeve dhe përbërjen e tij ku thuhet: brenda një dite nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese. Më falni, por në ndryshimet kushtetuese thuhet: “Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit miratohen rregullat e vetingut.” Si mund të krijosh një këshill të përkohshëm të emërimeve dhe ai të fillojë nga puna dhe me gjithë procedurën nga hyrja në fuqi, kur vetingu nuk është bërë akoma? Po këshilli i përkohshëm të emërimeve nuk duhet të kalojë në procesin e vetingut? Ai duhet të ishte i pari që duhej ta kalonte. Në këtë kuadër, unë do të doja dhe kam një kërkesë jo për ju, por e kam për kryetarin e komisionit, që ligji për prokurorinë, ligji për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit dhe ligji për qeverisjen, për organet e qeverisjes, duhet t’i shohim së bashku, sepse ka disa nene që janë përsëritje dhe që rregullohen në këto 3 ligje, por që nga leximi, unë nuk jam kaq e qartë, sepse shoh se në to ka rregullime të ndryshme, të cilat duhen shmangur për të qenë në unison.

Lidhur me shqetësimin tjetër, meqenëse ma morën zoti Xhafaj dhe zoti Vasili, edhe mua më ka rënë në sy në këtë ligj raporti midis 3 pushteteve.

Zoti Vasili u largua, por unë nuk e shoh të qartë në ligj komunikimin midis inspektorit të lartë të drejtësisë dhe ministrit të Drejtësisë. Në rast se ministri i Drejtësisë merr ankesa nga të dënuarit që janë nëpër burgje, meqenëse i ka në varësi, nga qytetarë që janë në shërbimin e provës dhe shërbimeve të lira. A ka të drejtë t’i adresojë këto tek inspektori? A mendoni se kjo zgjidhet me formulimin që keni bërë te neni 134, ku thuhet: “Çdo organ publik mund t’i adresojë inspektorit ankesa”? A nuk do të ishte më mirë që raporti midis tyre të qartësohej dhe të mos ta konsideronim, sikur ky të ishte ministri i burgjeve apo ministri i përmbarimit apo ministri i shërbimeve të lira, por quhet ministri i Drejtësisë, për ta parë këtë proces?

E dyta, nuk shoh ndoshta mund të jetë nëpër të, por nuk shoh si lidhet KLD-ja me inspektorin e lartë të drejtësisë për masat disiplinore. Ju thatë që është një risi, sepse ai që heton, nuk e jep masën. Këtë do të doja ta shihnim pak më shumë.

Për pjesën tjetër të ligjit, komplimente për anën e teknikës legislative që ka shumë pak punë për të bërë, për sqarimin, qartësinë e neneve, procedurat shumë të detajuara, që nuk lënë shteg për keqinterpretime, përveç këtyre çështjeve që ju me të drejtë nuk mund të ndikoni, sepse këto janë diskutime të karakterit politik dhe kurrësi nuk do ta kërkoja nga ju të prononcoheshit.

**Fatmir Xhafaj** – Duhet të bëjmë një dallim midis karakterit të diskutimeve për politika dhe karakterit të diskutimeve politike. Nëse flasim për politika, nuk ka asnjë gjë të keqe, sepse edhe ata për politika po flasin, për politikat në sistem është edhe vetë ligji. Kjo është diferenca nëse flasim nga pikëpamja e pozicioneve politike partiake. Ata nuk mund të përfshihen, por ne, për mënyrën si do të funksionojnë politika të caktuara...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Një lloj qeverisjeje është politika në sistem.

Besoj se do të kemi një përgjigje të përmbledhur për pyetjet e qarta të zonjës Hysi, që ka edhe cilësinë dhe përgjegjësinë e relatores në këtë projektligj, natyrisht, pa hyrë në detajet që duhet t'i shikojmë të gjithë bashkë gjatë diskutimit nen për nen. Unë besoj se edhe këto ditë, nga ky diskutim, deri në shqyrtimin nen për nen, ju do të uleni për të reflektuar për aq sa çmoni, prandaj po bëhen pyetje apo komente në parim, në mënyrë që t'ju japim kohën e nevojshme.

Urdhëroni, zoti Ibrahim!

**Gent Ibrahim** – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Faleminderit, zonja Hysi!

Për pyetjen rreth modeleve, pa dyshim që Këshilli i Lartë Gjyqësor që propozohet dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përkon me një model. Në përgjithësi, një vështrim global për këshillat gjyqësore në Europë të çon në përfundimin se ka dy modele të mëdha: një model ku këshillat gjyqësorë janë vërtetë qeveri të gjyqësorit dhe përmbledhin të gjitha përgjegjësitë e mundshme në këtë fushë, si: administrimin, menaxhimin e çështjeve, teknologjinë, marrëdhëniet me publikun dhe grupin e çështjeve që ka të bëjë me statusin e gjyqtarëve. Tipikisht këtë lloj Këshilli të Lartë Gjyqësor e shikon në vendet e Europës së Veriut, në Skandinavi, në Holandë.

Ka edhe një model tjetër këshillash, kompetencat e të cilave janë të përqendruara në çështjet e statusit të magjistratit, në emërimin e tyre, vlerësimin, disiplinimin. Këtë lloj këshilli kemi dhe ne aktualisht dhe ky model gjendet kryesisht në vendet e Europës Jugore, në Francë, Itali e të tjera.

Ne kemi bërë zgjedhjen e parë, të një këshilli që shkon gjithmonë e më shumë drejt një qeverie të fuqishme të gjyqësorit. Arsyet për këtë janë të artikuluar në një masë të madhe tek analiza e sistemit të drejtësisë dhe zgjedhjet, në një farë mënyrë, janë parathënë te strategjia, por unë mund t'i përmbledh. Mënyra se si është administruar gjyqësori gjithë këta vjet në Shqipëri lë për të dëshiruar. Kemi pasur probleme me vlerësimin e gjyqtarëve; kemi pasur probleme me

disiplinimin e tyre; kemi pasur probleme me administratën gjyqësore, që ka qenë një fushë e madhe gri, një fushë përgjegjësish pa zot; kemi pasur probleme madhore me sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe me financimin e sistemit. Pra, gjithçka që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit ka qenë një problem. Si shkak për këtë kemi identifikuar edhe faktin që përgjegjësitë nuk janë alokuar aty ku duhet, në disa raste janë alokuar në mënyrë të pamjaftueshme ose në mënyrë të paqartë.

Në nivel strategjik kemi qenë të mendimit se vendosja e përgjegjësive të rëndësishme në kësulën e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të ishte një hap në drejtim të ushtrimit më të efektshëm të tyre sesa ndarja midis shumë aktorëve. Kur vjen puna për të ushtruar përgjegjësi, e mira është që përgjegjësia t'i lihet qartësisht dikujt dhe të mos ketë zgjidhje ambivalente.

Për sa u takon dy momenteve, ku projekti ju vë ju në dijeni që ka pasur mendime të ndryshme nga anëtarët e grupit të punës, po, janë çështje politike, siç e tha zoti Xhafaj. Në një farë mënyre, ne si ekspertë e kemi bërë zgjedhjen, derisa kemi lënë në draft njërin nga dy opsionet, por kemi shënuar në *footnote* tjetrin.

Unë e kuptoj shqetësimin tuaj për mënyrën e përzgjedhjes në fakultete dhe dominimin e pamerituar që mund të kishin në llogari të fundit universitetet private, për të gjitha arsyet që thatë ju, që shpeshherë nuk janë të akredituara, dhe kur janë të tilla ka dyshime të arsyeshme për cilësinë e mësimdhënies, por edhe mënyra si organizohen dhe funksionojnë. Në rastin tonë ka rënduar më shumë në kandar nevoja për të pasur më shumë kandidatë. Por, në rast se ajo që thatë ju, të cilës unë, për fat të keq, nuk jam në gjendje t'i jap përgjigje, se pedagogët e fakulteteve private, që figurojnë si permanentë, në fakt, janë permanentë edhe në Fakultetin e Drejtësisë, në një farë mënyre, përpjekja jonë për të zgjeruar grupin e kandidatëve është e dështuar. Kështu që, unë me një reagim të shpejtë do ta pranoja nëse ju bëni një zgjidhje të kundërt, që procesi i përzgjedhjes së kandidatëve të përqendrohet vetëm brenda fakulteteve dhe departamenteve të universiteteve publike, duhet të bëjmë edhe një llogari numerike për sa njerëz bëhet fjalë në skenarin A, kur universitetet publike dhe private përfshihen në procesin e përzgjedhjes, kur dhe për sa njerëz bëhet fjalë në skenarin B, ku përfshihen vetëm pedagogët e universiteteve publike.

Për sa u takon formulave të ndryshme për caktimin e komisioneve të votimit, ka qenë një përpjekje për të reflektuar realitetin institucional brenda grupeve të profesionistëve, që kanë të drejtën të zgjedhin përfaqësues në këshilla.

Në rastin e gjyqësorit, ideja ka qenë që procesi të jetë sa më i distancuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Duke qenë se Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucioni, anëtarët e së cilit po përzgjidhen, roli në procesin përzgjedhës duhet t'i takojë një institucioni tjetër, Gjykatës së Lartë është propozimi. Aty kanë disa zgjedhje, që ndonjëherë janë të diktuar nga disa nevoja praktike të tipit që nuk mund t'i kërkosh kryetarit të Gjykatës së Lartë që të numërojë votat, gjëra të kësaj natyre. Por, në çdo rast, ne i jemi referuar strukturës organizative të këtyre institucioneve, të gjyqësorit, të avokatisë, të noterisë, të universiteteve, për të identifikuar atë organizëm që do të ishte më i natyrshëm në zhvillimin e atij roli, në bërjen e thirrjeve. Cili do t'i bëjë thirrjet për shprehjen e interesit? Një subjekt i natyrshëm. Cili do të bëjë shqyrtimin e shprehjeve të interesit dhe të verifikimit të plotësimit të kushteve? Përsëri një subjekt që të ketë një autoritet e kështu me radhë. Do të ishte mirë të ishim uniformë me zgjedhjet, në fakt, por na ka rezultuar pak e vështirë kjo dhe jeni përpjekur t'i përgjigjemi realitetit institucional brenda këtyre grupeve.

Për problemin e raportit të Këshillit të Emërimeve me ILDKPI-në, në këtë rast bëhet thjesht një rregullim i tillë, që i kërkon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të mbajë parasysh rezultatin e verifikimit. Kompetenca i mbetet ILDKPI-së, pa dyshim, por Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i kërkohet të marrë parasysh rezultatin e verifikimit të pasurive në verifikimin e plotësimit të kushteve dhe e dyta, më e rëndësishmja, në renditjen e kandidatëve.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) – Dua të shtoj diçka për afatet e shkurtra për përcaktimin e grupit të Këshillit të Emërimeve. Neni 179, paragrafi i dymbëdhjetë i Kushtetutës, parashikon që Presidenti duhet të zgjedhë Këshillin e Emërimeve paraprakisht brenda 5 ditëve. Pra, 5 ditë janë shumë pak, prandaj parashikimet tranzitore shikojnë diçka më të shkurtër në aktivitetet ditore për t'i shërbyer të gjithë situatës: të sigurosh që zbatohet vetëm për fazën e parë paraprake dhe fazat e tjera janë të parashikuara me ligj.

Për sa i përket rolit të ministrit për ankesat, kjo parashikohet edhe në status quo, në nenin 128 të ligjit të statusit, që ministri është organ ankimues, kështu që mund të nisë një proces investigimi dhe hetimi, gjithashtu. Pra, është një palë në të gjithë procesin, mbetet zëri i tij në procesin e hetimit.

Me komentin e zonjës Hysi për ndërveprimin midis institucioneve, dua të kujtoj se një nga kompetencat që i besohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është inspektimi i gjykatave dhe i zyrave të prokurorisë. Në ushtrimin e kësaj kompetence projektligji parashikon që inspektori mund të veprojë me nismë, natyrisht, por tipikisht, atij do t'i duhet të marrë parasysh edhe

orientimet, rekomandimet, gjetjet dhe indiciet që vijnë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, prokurori i Përgjithshëm, Kuvendi, ministri i Drejtësisë dhe çdo subjekt tjetër i interesuar. Pra, ky është një kanal i mundshëm komunikimi. Për verifikimin e ankesave ose të hetimit të shkeljeve disiplinore inspektori mund të vihet në lëvizje me bazën e informacioneve të çdo organi publik të interesuar, që do të ishte ministri i Drejtësisë tipikisht, por nëse është vendi për ta thënë shprehimisht, edhe çdo organ tjetër, në qoftë se kjo e zbut shqetësimin, kryesisht të zotit Vasili, por edhe tuajin. Kjo është diçka që mund të bëhet, megjithëse tani e tutje nuk do të jem kaq i lehtë në qëllim, duke pasur parasysh reagimin e zotit Vasili, kur iu duk sikur hoqëm dorë kaq thjeshtë nga një zgjidhje që duhej të ishte e mirëmenduar. Zgjidhja është e mirëmenduar, në fakt, por unë besoj se zgjidhja themelore mbetet edhe nga ndonjë...

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, kam përshtypjen se është një keqkuptim. Ajo që ju thatë nuk kishte lidhje me atë që reagoi zoti Vasili, sepse ju thatë se kjo është një zgjidhje kushtetuese dhe, nëse ka nevojë, mund të ndërhyhet në Kushtetutë, nuk e bëjmë ne këtu. Kjo thjesht nuk u kuptua, jam i sigurt për këtë gjë.

**Gent Ibrahimi** – Atëherë, mundësia që...

**Fatmir Xhafaj** – Ka një gjë, do të doja të isha më i qartë, dhe besoj se për kolegët është, meqenëse do të doja ta dëgjoja edhe nga ju. Nëse ka disa gjëra, për të cilat Komisioni i Venecias është shprehur qartësisht, se duhet apo nuk duhet të jenë, kjo çështje është e laboruar në të dyja opinionet e Komisionit të Venecias. Ne kemi rënë dakord që, për një mijë arsye, por edhe për objektivitetin e opinionëve të Komisionit të Venecias, të marrim kornizën brenda së cilës ne duhet kohë të lëvizim. Për sa kohë që ne do të duam të nxjerrim një këmbë jashtë kësaj kornize, nuk do të na lejohet. Kështu që, për Komisionin e Venecias ka përgjigje. Brenda kësaj hapësire mund të ketë zgjidhje që nuk cenojnë kufijtë, kornizën, po e quajmë kështu, dhe atëherë mund t'i laborojmë. Unë vetë isha partizan i kësaj gjëje, por mund të ndajmë pikëpamje të ndryshme dhe ne nuk e kemi problem të themi: “ndjesë, e menduam kështu”, por, sa kohë që një zgjidhje teknike justifikon qëllimin apo politikën në sistem, është kjo që keni dhënë ju, nuk ka arsye të insistojmë. Duhet të mirëkuptoni se të gjitha këto janë në sensin e këndvështrimeve që bëjmë ne se si mund ta shikojmë, por nuk do të thotë se këto që themi janë zgjedhje që duhet të imponohen. Ju na keni mësuar të shtojmë fjalinë “nuk mbajmë përgjegjësi për atë që themi”.

**Gent Ibrahim** – Fakti që në rastin e kapitullit të inspektorit ne ia kemi dalë, që pa e vënë në diskutim urdhërimin e draftkushtetutës të gjenden disa mënyra për të bërë një zgjidhje më racionale, tregon se hapësira ekziston kudo, kështu që, në këtë kuptim, diskutimi është shumë i vlefshëm.

Për t'u kthyer te pyetja e zonjës Hysi, se si ndërvepron inspektori me institucionet e tjera, duke pasur parasysh që inspektori ka dy grupe kompetencash: grupi i parë është verifikimi i ankesave dhe hetimi i shkeljeve të dyshuara disiplinore dhe grupi i dytë është inspektimi institucional, në të dyja këto raste inspektori mund të vihet në lëvizje me nismë, pa dyshim, por edhe me informacione nga organet publike, nga një informacion i ardhur qoftë edhe vetëm nga një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, apo edhe nga një kryetar gjykate ku punon gjyqtari që mendohet se ka bërë një shkelje, informacion i ardhur nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë, ku punon prokurori që dyshohet se ka bërë një sjellje jo të ligjshme, si dhe nga të dhënat që vijnë nga mediet apo nga të dhënat që sigurohen në kuadrin e inspektimeve institucionale dhe tematike. Pra, ka një ndërveprim, përveç veprimit standard procedural që ndërveprohet në procedurat disiplinore. Pra, unë ngre akuzën si inspektor, ti si këshill je në pozitën e gjykatës. Pra, besoj se ka ndërveprim midis këtyre institucioneve.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Besoj se u qartësuan të gjitha pyetjet e ngritura në princip nga ana e kolegëve dhe është e mjaftueshme për ta mbyllur këtë pikë të rendit të ditës, për t'i dhënë mundësi relatores, që me pasionin e saj karakteristik dhe akademik të paraqesë javën që vjen qëndrimin për këtë projektligj, me një këshillë shoqërore: të mos përqendrohet vetëm te Fakulteti i Drejtësisë, te pika e dobët e saj.

E mbyllim këtu këtë pikë të rendit të ditës, në mënyrë që t'u japim mundësi të ndërrojnë letrat dhe përgatitemi për pikën tjetër.

Kemi 5 minuta pushim, me kërkesë të zonjës Hysi.

**Fatmir Xhafaj** - Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Kemi votuar në parim projektligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, kurse tani kemi shqyrtimin nen për nen.

Atëherë, fillojmë me shqyrtimin nen për nen.

**Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!**

Para se të fillojmë me shqyrtimin nën për nen, kam dy konsiderata të përgjithshme. Ky ligj është shumë i rëndësishëm dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me ligjin që sapo diskutuam në parim “Për organizimin e prokurorisë”, të cilin e diskutuam ditën e mërkurë, njëkohësisht ky ligj ka lidhje edhe me ndryshimet kushtetuese.

Nga leximi me vëmendje që i kam bërë projektit konstatoj se të tri ligjet, bashkë me ligjin “Për ndryshimet kushtetuese”, duhen parë së bashku, sepse ka institute ose ka nene, që rregullojnë të njëjtin institut, por nga mënyra se si janë riformuluar duhen unifikuar.

Së dyti, shoh një disbalancim në rregullimin e statusit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve lidhur me privilegjet që ata kanë, të drejtat që u jepen dhe përgjegjësitë.

Pyetja që kam në parim, para se të filloj të komentoj nen për nen, ka të bëjë me praktikën e vendeve që e kanë një ligj të tillë. Kur bëhet fjalë për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit ne duhet të flasim se si ta mbrojmë atë, që të jetë i garantuar në detyrën e tij, të jetë i pavarur, të jetë i mbrojtur ai dhe familja e tij, apo një gjyqtar ose një prokuror kur është në detyrë duhet të ketë edhe disa përgjegjësi që duhet t’i përmbushë. Këtu nuk e kam fjalën për konfliktin e interesit apo konfliktin ambiental, që tashmë janë të rregulluara, por mendoj se ka një sërë papajtueshmëri dhe përgjegjësish të tjera, që duhet t’i përmbushin gjyqtarët dhe prokurorët.

Së fundi, dua që për disa nene diskutimi të mos shterojë, por le ta lemë të hapur. Këtu e kam fjalën pikërisht për kapitullin për të cilin fola gjerësisht, lidhur me përfitimet e pagës dhe privilegjet, pra për përfitimet e tjera jofinanciare. Ky është një problem shumë parimor, sepse ky ligj nuk mund të bie ndesh me ligjet e tjera që ne i kemi miratuara dhe me mënyrën se si funksionon e gjithë struktura e institucioneve, e organeve publike në Republikën e Shqipërisë.

Nga materiali që përmendi zoti Ibrahim herën e fundit, unë hyra dhe pashë të dhënat e CEPEJ-it. Aty rezulton që me të vërtetë gjyqtarët dhe prokurorët duhet të kenë një pagesë më të mirë, por kurrësi paga e një gjyqtari apo e një prokurori nuk mund të jetë disa herë më e lartë se paga e Presidentit të Republikës, ose që hierarkia e pagave të ndryshojë. Unë kam parë modelet e vendeve të Europës, por asnjëri nuk ka këtë lloj diference page me pagën e Presidentit apo të Kryeministrit. Pra pagat e tyre janë nga 4,4 herë më të larta deri te 1,6-1,7-paga e Presidentit ose e Kryeministrit. Nuk mund të ndodhë e kundërta, siç ndodh te ne, që pagat e gjyqtarëve të shkallës së parë, pa përfitimet të tjera, të kalojnë pagën e Presidentit të Republikës.



Gjithashtu, në lidhje me përfitimet, po të shikojmë raportin e fundit të CEPEJ-it, të vitit 2014, ku janë analizuar 26 vende të BE-së, gati 90-95% e këtyre vendeve nuk gëzojnë asnjë nga privilegjet që ne i kemi parashikuar në ligj. Po të shikoni përgjigjet këtu janë të gjitha “jo”. Pse e them këtë? Sepse ky është një ligj, që nuk ka ardhur si nismë e qeverisë dhe duke mos ardhur si nismë e qeverisë, (pra është një ligj i përgatitur nga grupi i ekspertëve dhe i depozituar në komision) Kushtetuta ka parashikuar disa rregulla strikte lidhur me nismat ligjore që nuk janë nismat e qeverisë. Kështu, në Kushtetutë thuhet që për çdo nismë ligjore që nuk vjen nga qeveria, ligji duhet të jetë shoqëruar me faturë financiare. Në këtë ligj fatura financiare mungon dhe për mua është shumë e vështirë të përcaktoj në përgjithësi faturën financiare, sepse duhet të di numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, duhen përlllogaritur për çdo institucion të gjitha pagesat dhe shtesat që marrin.

Pra, për ta mbyllur, unë shoh një vëmendje shumë të madhe, një përkujdesje jashtëzakonisht të madhe për të rregulluar statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit nga pikëpamja financiare, duke menduar dhe mbështetur idenë se korrupsioni në drejtësi dhe mungesa e efikasitetit kanë ardhur për shkak se ata kanë pasur rroga të vogla. Unë këtu ndaj mendim ndryshe. Unë e vlerësoj pagesën, si një nga kriteret që i jep dinjitet figurës së gjyqtarit dhe prokurorit dhe çdo funksionari të lartë për vështirësitë dhe rrishtet që ata kanë në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë dhe të administratës publike, por nuk është vetëm kjo. Ne jemi dëshmitarë, ku gjyqtarë me pagesa shumë të mira janë të korruptuar, ashtu sikurse një pjesë e mirë e gjyqtarëve, të cilët janë profesionistë, jetojnë vetëm me pagën minimale dhe përsëri janë të korruptuar, në krahasim me ata që kanë bërë emër për korrupsion në sistemin e drejtësisë. Që ky ligj të mos dëmtohet për shkak të faturës financiare, sepse merr një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të shtetit, meqenëse zbatimi i tij fillon menjëherë vitin e ardhshëm, dua që këto dispozita t'i linim me rezervë dhe të mos i përmbysim deri në pritje të përgjigjes nga Këshilli i Ministrave.

Kjo ishte çështja në parim që unë desha ta theksoja që në fillim. Dua të mos më keqkuptoni, pasi nuk kam absolutisht asgjë për faktin që është dhënë gjithë ky përkujdes i madh për këto paga.

**Fatmir Xhafaj** - A mund të fillojmë tani?

**Vasilika Hysi** - Po.

Lidhur me nenin 1 të ligjit, zoti kryetar, kam një sugjerim, që në qoftë se do të pranohet e kam edhe për shumë nene të tjera, është mirë që të shmangim sa të jetë e mundur copëzimin e

neneve me germa “a”, “b”, “c”, “d” “e”, sepse ligji na ka dalë shumë i copëzuar. Duke hequr këto germa ne shmangim edhe përsëritjen e fjalëve “kriteret dhe procedura”.

Unë sugjeroj që neni 1 të lexohet si më poshtë vijon, në qoftë se e pëlqeni nga pikëpamja e teknikës dhe më pas t’i përdorim atje ku është mundur: “Objekti i këtij ligji është të përcaktojë statusin e magistratëve dhe ndihmës-magjistratëve, duke parashikuar rregulla për të drejtat dhe detyrimet e tyre; për pranimin dhe emërimin e tyre; për zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; për vlerësimin etik dhe profesionale të tyre; për përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre”. Pra, në këtë mënyrë shmangen disa herë fjalët “kriteret dhe procedurat të tyre” dhe ligji lexohet më qartë dhe më saktë. Nuk e di nëse bini dakord në parim, sepse më pas nuk kam pse t’i përsëris disa herë kur të them riformulimin nga pikëpamja e teknikës së shmangies së germëzimit.

**Fatmir Xhafaj** - Kush ka ndonjë koment?

**Agnes Bernhard** –*(flet anglisht)* Jam dakord!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

**Vasilika Hysi** - Lidhur me “Përkufizimet”, sugjerimi i parë është që të shmangim edhe përkufizimet, edhe sqarimin.

Së dyti, nga ana parimore unë mendoj se ka nevojë për disa terma të tjerë, që përdoren gjerësisht në tekst dhe nuk përfshihen në pjesën e përkufizimeve.

Së treti, kam një sugjerim lidhur me renditjen e tyre, të bëhet dallimi i përkufizimit “sqarim” nga “detajimi”, sepse disa përkufizime mund të jenë në nen dhe nuk kanë pse të jenë përkufizime, pasi nuk përbëjnë element të përkufizimit. Nëse kalojmë konkretisht paragraf më paragraf, lidhur me germën “b” mendoj se fjalia e dytë nuk ka vend për të qenë te “Përkufizimi”, por kjo germë duhet të riformulohet.

Gjithashtu, lidhur me germën “d”, në fjalinë e dytë ku thuhet: “Për këtë qëllim ndihma përfshin, në veçanti, kryerjen e kërkimit ligjor dhe përgatitjen e opinionëve”, mendoj se duhet shkruar. Unë këtu kam bërë një redaktim, por për të qenë sa më korrektë kam një pyetje për Agnes: ndihmësmagjistratët do të përfshihen vetëm në fushën e kërkimit ligjor, në përgatitjen e opinionëve me shkrim për çështjet ligjore, materiale ose procedurale, apo kanë edhe angazhime të tjera? Nëse kanë vetëm këto që janë përkufizuar në fjalinë e dytë, atëherë kjo fjali shkruhet në të parën dhe bëhet një riformulim që lexohet më mirë dhe shkurton përsëritjet në tekst.

**Fatmir Xhafaj** - Po, zonja Bernhard.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Ndhimësmagjistratët janë persona, të cilët kanë statusin e magjistratit, që duhet të dallohen nga ndihmësit ligjorë, që ne kemi para shikuar në ligjin “Për pushtetin gjyqësor”. Në fakt, ata duhet të punojnë në këto qendrat kërkimore në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë apo në Prokurorinë e Përgjithshme.

**Vasilika Hysi** - Pra, ndihma e tyre është thjesht për këto 3 elemente që ju i keni përshkruar në fjalinë e dytë? Pra: kryejnë kërkime ligjore; përgatisin opinione me shkrim për çështje ligjore, materiale dhe procedurale.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Lidhur me germën “e” këtu thuhet : “I diplomuar është personi, i cili nuk është caktuar ende në pozicion”. Shprehja “caktuar ende në pozicion” , herë thuhet “caktim në pozicion”, herë thuhet “emërim”, herë ka një terminologji tjetër për ligj.

Në këtë kuadër, do të kërkoja nga ana juaj të dija më mirë skemën e pozicioneve të mundshme që mund të ketë një i diplomuar, një i emëruar, sepse herë përdoret skema e mobilitetit, një herë tjetër thuhet “i komanduar”, një herë “emërim i përkohshëm”, pastaj thuhet “transferim”, pra jepen shumë variante pozicionesh. A është e mundur që në të gjitha rastet të kemi parasysh se kush shkon në secilin nga këto pozicione? Kjo nuk lidhet vetëm me këtë nen, por me përmbajtjen e ligjit.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Ky ligj parashikon koncepte të reja. Aktualisht, në sistemin tuaj ju kemi vetëm emërimet, ku futet pjesa për transferimet, ngritjet në detyrë. Tashmë këtu duhet bërë një dallim për hapat e ndryshëm në karrierë. Hapi i parë në karrierë është emërimi në sistem. Në momentin që t’i emërohesh në sistem njihesh si gjyqtar apo prokuror dhe kjo duhet të dallohet nga fakti kur caktohesh në një pozicion të caktuar dhe duhet të dallohet edhe në rastin kur transferohesh nga një pozicion në tjetrin, ose ngritja në detyrë nga një nivel në tjetrin. Pra, këtu synimi është që të bëjnë të qartë që këto lëvizje janë të ndryshme dhe përbëjnë hapa të ndryshëm në zbatimin e karrierës. Kriteret për t’u caktuar në një pozicion të caktuar; për t’u transferuar; për t’u ngritur në detyrë, apo për t’u komanduar janë të ndryshme. Kjo është arsyeja pse ne kërkojmë që të kemi terma të ndryshëm për hapa të ndryshëm.

**Vasilika Hysi** - Sugjeroj që germa “f” të riformulohet për të shkrirë fjalinë e dytë.

**Fatmir Xhafaj** - Thuaji të gjitha germat nga “f-ja” deri te “zh-ja”.

**Vasilika Hysi** - Në rregull!

Njëkohësisht te germa “j” kur themi: “sasinë e çështjeve” mendoj se këtë term duhet ta unifikojmë, që sa herë të thuhet “numri i çështjeve”, “ngarkesa”, “sasia” duhet të biem në konsideratë.

Lidhur me germat “dh” dhe “m”, në fakt, më shumë me germën “m”, sepse këtu janë përdorur të gjithë germet e alfabetit, mendoj se ekziston mundësia që “transferimi” të mos jetë përkufizim. Këtu ku thuhet: ç’është transferimi, përkufizimi jepet me një, dy, tre apo katër germa “i”, pra unë mendoj të jetë në tekst. Te kreu “Transferimet” ne themi se çfarë është transferimi, por kur shkojmë te krerët e tjerë na duhet të kthehemi përsëri te neni 2 dhe të lexojmë përkufizimin për të kuptuar paragrafët që vijnë më pas.

Të njëjtën shqetësim e kam edhe për atë që quhet “pozicion i lirë” ose për “ngritjen në detyrë”. Do të ishte më mirë që këto të ishin nene dhe jo përkufizime, sepse këtu janë llojet e ngritjes në detyrë dhe llojet e transferimeve.

**Fatmir Xhafaj** - Po tjetër? Kaq ke për përkufizimet?

**Vasilika Hysi** - Po.

**Fatmir Xhafaj** - Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** - Meqenëse jemi te përkufizimet, te ligji “Për prokurorinë”, që diskutuam në parim, është futur si figurë “prokurori praktikant”. A mos ndoshta do të ishte e nevojshme të ketë një term, një parashikim apo një përkufizim se çfarë do të përfaqësojë “prokurori praktikant”?

Në ligjin “Për prokurorinë” thuhet vetëm që do të ketë edhe prokuror praktikantë, por nuk jepet një përshkrim më i detajuar se çfarë do të ushtrojë për atë kohë 1-vjeçare prokurori praktikant.

**Agnes Bernhard** *–(flet anglisht)* Ky ligj parashikon një dispozitë të veçantë për studentët e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës, të cilët punojnë në gjykata brenda praktikës së tyre profesionale.

Dispozitat përkatëse parashikojnë një përkufizim se çfarë do të bëjnë studentët e vitit të tretë gjatë praktikës profesionale. Ky është i vetmi rast ku ne u referohemi praktikave në gjykata. Lidhur me ligjin “Për organizmin e gjykatave”, kemi parashikuar mundësinë që studentët e drejtësisë, pasi të diplomohen nga Fakulteti i Drejtësisë, të punojnë si praktikantë ose si stazhierë në gjykata, por kjo duhet të dallohet nga studentët në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, që është pjesë e formimit të tyre, e parashikuar në ligjin për statusin.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Ky është shpjegimit juaj, kurse ajo që trajton kolegu dhe që duhet mbajtur në vëmendjen tuaj, po ashtu edhe të stafit të komisionit, është fakti që termat e njëjtë të ky ligj dhe të ligjet e tjera të paketës duhet të jenë të unifikuara, pra nëse për të njëjtën çështje ka dy terma, të cilat nuk janë të unifikuara qoftë në emërtim, qoftë edhe në shpjegim, nuk do të ishte pozitive. Kjo gjë, tashmë që e kemi kuadrin të plotë, na jep mundësinë ta reflektojmë, çka do të thotë që sekretariati teknik duhet të merret me këtë çështje, që të mos kemi përpjesëtime midis ligjeve të ndryshme.

Po, zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Në funksion të kësaj që thotë kryetari, në lidhje me unifikimin e termave, pothuajse të gjitha projektligjet që po diskutojmë këto ditë, në thelb përdorin vetëm 3-4 terma: magjistrat, ndihmësmagjistrat, ndihmësligjor dhe praktikant-prokuror. Do të ishte mirë që për secilën nga termat që përdorëm në ligjet që po diskutojmë këto ditë, të ketë një përkufizim dhe një dallim të qartë të rolit të gjithsecilit të këtyre figurave juridike, edhe për lehtësi të aplikimit nesër të ligjeve në praktikë, ata që do të punojnë me këto ligje, sepse nuk do të jemi ne ata që do t'i zbatojmë këto ligje, por do të jetë një komunitet shumë i gjerë gjyqtarësh, prokurorësh, avokatësh, noterësh, pra qartësimi i këtyre termave do të ishte për lehtësi, sepse janë rreth 3-4 terma që i përshkojnë këto ligje. Do të ishte mirë edhe për ne që të kemi një unifikim dhe një përdorim të këtyre termave, por edhe një qartësi se çfarë përfaqëson secili nga këta aktorë të sistemit të drejtësisë.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Po ashtu, zoti kryetar, në të gjithë nenin unë do të sugjeroja të hiqen gërmëzimet, të përdorim standardin që të jetë e dukshme fjala përkatëse, të hiqet numërtimi 1, sepse nuk ka 2, në paragraf. Njëkohësisht, te germa “N”, 3/I-ja, ku thuhet: “Ngritja në detyrë është kalimi ...”

**Fatmir Xhafaj** – Germa “N” është...

**Vasilika Hysi** – Germa “N” është “Ngritja në detyrë”. Është vështirë, sepse ...

**Fatmir Xhafaj** – Pra, 3/I-ja është një pozicion si magjistrat.

**Vasilika Hysi** – Jo, ka edhe 4 pastaj. Te 3-shi “Ngritja në detyrë”, “është kalimi, thoni ju, nga një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit...”. Nocionet “pozicion i

komanduar”, “pozicion në skemën e delegimit”, unë nuk arrij t’i kuptoj: kanë të njëjtin kuptim apo janë të ndryshme?

Gjithashtu, kur flisni për komandim, megjithëse do të flas edhe te neni ku flitet për komandimin, ju thoni: “Është lëvizja e magjistratit në një pozicion jomagjistrati, në institucion brenda sistemit të drejtësisë në të cilin komandohet, pra pozicion i cili siguron pavarësisë dhe mbron statusin e tij”. Këtë “pozicion, i cili siguron pavarësinë dhe mbron statusin e tij”, pra komandimin këtu unë nuk arrij ta kuptoj realisht. E di që një person mund të komandohet të bëjë këtë apo atë detyrë, por “pozicion që siguron edhe pavarësinë dhe mbron statusin e tij”, nuk arrij ta kuptoj.

Gjithashtu, germa “s” është “Shpjegimi i një pozicioni politik”. Ne kemi një ligj për pozicionin politik, pra kush janë personat politikë dhe pozicionet politike në ligjin e administratës. Thuhet: “Pozicion politik nuk konsiderohet pozicioni në strukturën profesionale ligjore të Ministrisë së Drejtësisë”, pra vetëm ky nuk konsiderohet pozicion politik? Të gjitha pozicionet e tjerat janë politike, në Ministrinë e Drejtësisë? Se cili është pozicion politik, është e përcaktuar në ligjin “Për administratën”.

Për sa u përket fjalëve “struktura profesionale ligjore”, cili është kuptimi? Mos duhet ta themi më qartë, pra të mos referohemi nëpër nene të tjera, sepse ligji “Për Ministrinë e Drejtësisë” mund të ndryshojë. Në qoftë se ne e themi në këtë ligj: “...referimi në paragraf, në nen të një ligji tjetër”, mund të duhet që me ndryshimin e këtij ligji për Ministrinë e Drejtësisë, t’u rikthem edhe ligjeve që u referohemi. Pra, për ta përmbyllur tre janë sugjerimet e mia.

E para, të qartësohen disa nga termat që përdoren në ligj dhe që nuk janë këtu.

E dyta, nga pikëpamja e teknikës legjislativë të hiqet germëzimi dhe të riformulohen më thjeshtë dhe ato pjesë të përkufizimeve, ose që janë dhënë si përkufizime, që, në fakt, janë sqarime të formave të transferimit dhe çfarë do të thotë “ngritje në detyrë”, të futen në nen dhe shpëtojmë nga shumë përsëritje. Nuk e di cili është mendimi juaj, pastaj, nga ana e teknikës legjislativë, i gjithë neni duhet rishkruar.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Mendoj se një nga parimet kryesore është që ky ligj duhet të jetë në përputhje me teknikat hartuese legjislativë shqiptare.

Në lidhje me pyetjen për përkufizimin e promovimit, rritjes në detyrë, mendoj se është një pyetje konceptuale. Pra, opsioni i katërt, varianti i katërt për rritjen në detyrë është për dikë që është i komanduar, ose që vepron në skemën e lëvizjes, që mund të rritet në një nivel më të

lartë. Për shembull, një magjistrat komandohet nga këshilli, punon për skemën e vlerësimit dhe gjatë komandimit të tij, ai aplikon për një pozicion në Gjykatën e Apelit, pra edhe kjo është një rritje në detyrë, pra në përkufizimin e rritjes në detyrë përfshihet edhe një rast i tillë.

Më pas, përkufizimi i komandimit, për të qenë e sinqertë u diskutua edhe me grupin e punës dhe pati një shqetësim se institucionet komanduese, si të tilla, mund të mos jenë mjaftueshëm për të siguruar se këto pozicione përcaktohen si pozicione komanduese, të cilat përputhen me profilin e një magjistrati, për shembull, Ministria e Drejtësisë. Pozicionet që duhet të hapen për magjistratët janë pozicione në departamentet legjislativë. Përfshirja e gjykatësve do të ishte mjaft përfituese për zhvillimin e akteve legjislativë, ndërkohë që pozicionet e tjera në Ministrinë e Drejtësisë, të cilat janë më të afërta me politikën, nuk janë të përshtatshme për profilin e një gjykatësi. Pra, ky përkufizim ka si qëllim të limitojë që gjyqtarët të mos komandohen nga institucione komanduese për pozicione, të cilat janë afër politikës. Prandaj, grupi i punës propozoi që ato duhet të përputhen, të jenë të përputhshme me pavarësinë e magjistratëve, por, patjetër, që gjatë komandimit magjistratët ruajnë statusin e magjistratit, nuk humbasin statusin prej magjistrati, por ndoshta kjo duhet të shprehet pak më qartë në gjuhën shqipe.

**Fatmir Xhafaj** – Me sa shoh këta që kanë qenë shqiptarë, që kanë punuar për këtë, e kanë kthyer anglisht dhe nga anglishtja e kemi marrë në shqip, por kjo ka qenë shumë e qartë në ligj. Është e qartë edhe në ligjin e Ministrisë së Drejtësisë. Këtu duhen përjashtuar vetëm ato që janë pozicione politike, në kuptimin e ligjit “Për shërbimin civil” dhe mbaron çdo diskutim tjetër.

Ligji “Për shërbimin civil” e ka fare të qartë se cilat janë pozicionet politike: ministër, zëvendësministër, kabinetet e ministrave, kur është fjala për ekzekutivin. E njëjta gjë është edhe me Kuvendin, nëse do të shërbenim në Kuvend, sepse këshilltarët e komisioneve në Kuvend janë nëpunës të shërbimit civil, nuk janë poste politike. Kështu që këto janë të përcaktuara qartë në ligjin e shërbimit civil, kështu që të kihet parasysh kur të zbardhet.

Dakord me ndryshimet që do të reflektohen në proces, me vërejtjet, me sugjerimet dhe me komentet që u bënë? Dakord.

Vazhdojmë me nenin 3 “Vlerat themelore, gjyqësore dhe prokuriale”.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 3, që nga titulli nuk jam dakord. Nuk di si mund ta riformulojmë, por unë them se këto janë vlera themelore në bazë të të cilave funksionon sistemi

gjyqësor dhe prokuroria. Këtë keni dashur të thoni, sepse “vlera themelore, gjyqësore”, termi “prokuroria” nuk është në fjalorin shqip. E para.

I gjithë neni duhet ..

**Fatmir Xhafaj** – Mund ta lëmë shkurt fare: “Vlerat themelore”, sepse kuptohet se për çfarë është objekti i ligjit dhe mbaron. Pse duhet t’i dini në çdo moment mbiemrin?

**Vasilika Hysi** – E dyta, ka nevojë për t’u riformuluar.

Për paragrafin e 3-të, unë sugjeroj që fjalia e dytë duhet të ndryshojë dhe të lexohet ndryshe. “Magjistrati ka detyrimin të njoftojë menjëherë kryetarin dhe këshillin nëse dikush tenton të ndërhyjë ose të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm ndaj tij”, pra fjalia mund të rregullohet.

Gjithashtu, “organet shtetërore” te paragrafi 6, ku thuhet: “Organet shtetërore duhet të respektojnë dhe të mbrojnë garancitë, duke siguruar pavarësi nëpërmjet emërimeve dhe zhvillimit të karrierës së magjistratit në bazë të meritës”, unë dua të di se cilat janë organet shtetërore që ju keni parasysh në këtë ligj, sepse ligji është për funksionimin e sistemit të gjykatave të prokurorive? Këtu ju po rregulloni detyrimin e organeve të tjera që duhet të respektojnë e të mbrojnë garancitë. E kam kuptuar qartë? Pra, me këtë ligj rregullojmë edhe detyrimet e organeve ndaj sistemit të prokurorisë dhe të gjykatave? Nëse po, unë sugjeroj një riformulim.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Ky paragraf nuk është rregullues, si paragraf, sepse nëse do të rregullonte edhe detyrimet e institucioneve të tjera, atëherë do të dilte jashtë qëllimit të këtij ligji. Nuk e kam pasur kurrë parasysh këtë gjë, por koncepti i grupit të punës ishte që ligje të tjera t’i parashikojnë. Për këto parashikime ka vetëm qëllim deklarativ dhe mund të hiqet fare.

**Vasilika Hysi** – Unë prandaj e bëra pyetjen, por duke pasur parasysh edhe diskutimin e projektligjit që sapo bëmë, “Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, unë mendoj që organet e sistemit të drejtësisë duhet të respektojnë dhe të mbrojnë garancitë. Një gjë e tillë mund të rregullohet. Kjo mund të jetë edhe te ligji “Për organet...”, pra që kur bëhet përzgjedhja të kihet parasysh zhvillimi i karrierës, ose mund të jetë edhe këtu, por të paktën të bëjmë lidhjen midis këtyre dy ligjeve. Nuk mund të vëmë në këtë ligj kushte për organe të tjera, që nuk kanë të bëjnë me qeverisjen e sistemit të drejtësisë. Nuk e di se sa korrekte jam me këto që them, por, të paktën...

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Do të propozoja ta hiqnim fare.



**Fatmir Xhafaj** – Keni gjë tjetër për nenin 3? Dakord me ndryshimet e bëra edhe për nenin 3.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 4, dua të di nëse është korrekt termi “masat e arsyeshme” kur thuhet në paragrafin e parë: “Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme”. Mos duhet “masat e nevojshme”, sepse ai mund të mos i gjykojë të arsyeshme në perceptimin e tij?

Gjithashtu, te pika 2 e po këtij neni thuhet: “Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar...”, pra përdoret në paragrafin e parë: “Magjistrati merr masa për të ruajtur dinjitetin”, në paragrafin e dytë thuhet: “Magjistrati merr masa për të mbrojtur dhe për të forcuar dinjitetin” dhe më poshtë thuhet: “Magjistrati kontribuon në rritjen e besimit, reputacionit e të tjera”. A mos është më mirë t’i përmbledhim dhe të themi: “Magjistrati merr të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur, mbrojtur dhe forcuar dinjitetin e funksionit, përfshirë edhe këto e me radhë”, sepse ka një farë përsëritjeje dhe përsëri i kthehem pyetjes: do të përdorim termin “sistemit gjyqësor” dhe atë “të prokurorisë” dhe të heqim termin “prokurorial”?

Çështja tjetër thelbësore është pika 4, ku thuhet: “Secili këshill emëron magjistratin më të vjetër, si këshilltar të etikës, i cili këshillon në mënyrë kofidenciale”. Kur themi magjistrati më i vjetër, është fjala për magjistratin më të vjetër në moshë apo për magjistratin më të vjetër në detyrë dhe kur thuhet: “këshillon në mënyrë konfidenciale magjistratët”, mos është këshillim individual, rast pas rasti, sipas kërkesës, sepse “konfidencial” ka edhe një konotacion tjetër.

Për pikën 4, jam për riformulim pas marrjes së përgjigjes nga ana juaj se çfarë keni dashur të rregulloni në pikën 4, të nenit 4?

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Në paragrafin e parë pyetje nëse duhet “e arsyeshme” apo “e nevojshme”, shikoj një diferencë midis kuptimeve të të dyjave, sepse “të nevojshme” janë ato masa që janë të orientuara te rezultatet, pra të gjitha masat për të ruajtur dinjitetin. Nëse dinjiteti nuk ruhet, nuk janë marrë masat e domosdoshme, ndërsa masat “e arsyeshme” janë ato që janë të arsyeshme për atë person, në një situatë konkrete, pra ato lidhen me një situatë konkrete dhe jo domosdoshmërisht kërkojnë që të arrihet një rezultat; mund t’i kesh marrë të gjitha masat e arsyeshme, por dinjiteti nuk është siguruar në fund. Shikoj një diferencë midis të dyjave, por nëse keni ndjesinë se në shqip ky term nuk është i përshtatshëm, atëherë përdorim “të nevojshëm”, por mendoj se “i arsyeshëm” është më i fuqishëm në këtë pikë.

Gjithashtu, te paragrafi i dytë, të paktën, në versionin anglisht, ka një ndryshim midis shkronjave, ka një ndryshim midis “të ruash dhe të përmirësosh dinjitetin e një profesioni, i cili

lidhet me dinjitetin në një gjykatë, për sjelljen përkatëse”, kurse shkronja “B” përkon me reputacionin, i cili ka të bëjë me se si të tjerët më perceptojnë mua, ka të bëjë me sjelljen time dhe, gjithashtu, edhe me faktin se sa besim ka publiku në sistem.

Aspekti i tretë është pak më i gjerë. Ai lidhet me të gjithë aspektin e statusit të gjykatësve. Pra, në perceptimin tim, ka pika të ndryshme midis të tria këtyre kryeradhëve, por mendoj se nuk është një pjesë kaq thelbësore. Në qoftë se doni ta bashkojmë të gjithë, nuk ka asnjë problem.

Në paragrafin e katërt çdo këshill duhet të emërtojë një magjistrat. E kemi rregulluar në parim, por rregullat më të detajuara janë në ligjin e qeverisjes kur detyrat e këtyre këshilltarëve, të cilët punojnë nën Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe të prokurorisë përcaktohen më qartë detyrat dhe detyrimet e tyre.

Gjithashtu, përcaktohet edhe mënyra sesi ofrohet këshillimi në mënyrë individuale. Atje përcaktohet shumë qartë.

**Gent Ibrahimi** – Një koment për paragrafin 4. Ashtu siç është shkruar, ai bie ndesh me rregullimin përkatës të ligji për organet e qeverisjes. Kështu që unë do të propozoja një frazim më të përgjithshëm që secili këshill emëron një magjistrat që të shërbejë si këshilltar i etikës, sipas rregullave të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes”, sepse aty nuk thuhet magjistrati më i vjetër, por thuhet një magjistrat, që plotëson kushtet për të qenë anëtarë i Gjykatës së Lartë. Kështu që duhet të jetë pak më e përgjithshme, që çdo këshill emëron një magjistrat sipas kriterëve dhe procedurave të parashikuara në ligjin për qeverisjen që të shërbejë si këshilltar i etikës.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 4 bashkë me sugjerimet e bëra.

Neni 5.

**Vasilika Hysi** - Lidhur me nenin 5 janë probleme redaktoriale, por njëkohësisht kam një pyetje për periudhën e formimit, parashikuar në paragrafin 3 të nenit 5, “Periudha e formimit vazhdues është lënë jo më pak se 3 ditë të plota në vit dhe jo më pak se 25 orë ditë të plota në 5 vjet”. Cili është kriteri që është përzgjedhur, që një magjistrat të ketë jo më pak se 3 ditë të plota dhe jo më shumë se 20 ditë në vit? 20 ditë në vit në total, mendoni se është e mjaftueshme? Pse duhet të ketë këtë lloj kufizimi?

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Nuk ka rregulla të qarta të një trajnimi minimal. Kjo është arsyeja pse ne donim të kishim një trajnim minimal, për t'i bërë ata përgjegjës nga ana disiplinore në qoftë se ata nuk marrin pjesë në trajnim.

Maksimumi prej 20 ditësh në vit është ajo çka është e parashikuar aktualisht në ligj. Pra, është vazhdimi i *status quo* në këtë aspekt.

Sigurisht mund të diskutojmë lidhur me këtë. 20 ditë të plota është një muaj, por, nga ana tjetër, në këtë ligj kemi edhe mundësinë për të reduktuar ngarkesën, në mënyrë që të trajnohen, që nuk është përfshirë në këtë aktivitet trajnues.

Gjithashtu, ne duhet të garantojmë një praktikë të keqe, e cila nuk është aq urgjente në Shqipëri, por ndonjëherë krijohet në zona të tjera, në fusha të tjera, ku kam dëgjuar edhe nga prokurorët, që ai nuk ka bërë një raport të vetëm hetimi, por ka pasur shumë trajnime gjatë këtij viti.

Pra, trajnimi duhet të jetë i rëndësishëm, duhet të ketë lidhje me punën e zhvillimit profesional dhe duhet të ketë një synim dhe një kufi përgjatë vitit.

**Vasilika Hysi** - Në nenin 5 te paragrafi 4 ju thoni që magjistrati duhet të ndjekë programe të përshtatshme për funksionin e tij. Ndërkohë, sqarimi juaj ishte më i qartë, më i saktë dhe më i mirë për llojin e programeve që do të ndjekë, por njëkohësisht edhe për ditët.

Nga ana tjetër, mos harroni se ndryshimet e legjislacionit këto kohët e fundit janë shumë dinamike për shkak se Shqipëria po përshtat legjislacionin me *acqui communautaire* dhe nevoja e magjistratës për të pasur formim vazhdues do të jetë më i madh.

Ne kemi një ligj të ri të falimentimit, që besoj se nuk e njeh njeri për momentin. Po marr një rast, pra, ligjin e falimentit, por sa e sa ligje të tjera, ose vetë paketën që ne kemi sot, sa punë u duhet gjyqtarëve, prokurorëve të njohin pozicionin e tyre, organet e qeverisjes me ligjet e reja? Duke lënë 25 ditë në 5 vjet, për mendimin tim, është pak në këtë lloj dinamike me të cilën parlamenti shqiptar po miraton ligje, të cilat nuk i kemi studiuar në universitet. Janë fusha të cilat nuk i kanë bërë. Flas për magjistratët, që kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës dhe që në bazë të dispozitës kalimtare qëndrojnë në sistem, por ata kanë nevojë të përditësohen dhe 25 ditë në 5 vjet për mua nuk është asgjë.

E dyta, kur ju thoni se duhet marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për të përditësuar me ndryshimet legjislative dhe me jurisprudencën, që do të ishin masat e tjera të arsyeshme, ka

nevojë për ta elaboruar pak më mirë. Nuk mund t'i themi magjistratit të marrë masat. Çfarë masash? Të blejë librin? Nuk mjafton. Atëherë është detyrimi i Shkollës së Magjistraturës.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Ne mund ta rrisim numrin e ditëve maksimale që të mos kufizojmë në mënyrë të panevojshme trajnimin, që është mjaft i rëndësishëm. Për sa u takon hapave të arsyeshme, që duhet të merren për të përditësuar vetveten sigurisht ne mund të përfshijmë këtu disa shembuj, por mjeti kryesor nuk është të lexojmë dhe të studioni vetë apo ne shpjegimet e tyre. Nuk e di nëse ne realisht kemi nevojë për këtë shpjegim në ligj, por ne mund të mendojmë për disa formula më të qarta për ta bërë më të qartë se çfarë duhet të bëjnë konkretisht gjyqtarët në këtë drejtim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimet dhe sugjerimet.

**Vasilika Hysi** – Për paragrafin e pestë dhe të gjashtë, një nga problemet e konstatuara në këtë periudhë lidhur me formimin vazhdues të magjistratëve janë shpenzimet, pra, pamundësia e tyre për të mbuluar shpenzimet .

Më vjen mirë që ju keni menduar që shpenzimet për udhëtimin dhe qëndrimin, kur magjistrati vjen për programe formimi vazhdues, mbulohen nga buxheti. Nga buxheti i cilit institucion? Sepse ka pasur një përplasje midis buxhetit të gjykatës dhe Shkollës së Magjistraturës. Secili nga këto institucione ka buxhetin e tij në tërësinë e buxhetit që ndan zyra e gjyqësorit. Pra, është mirë të përcaktohet se në cilin buxhet të institucionit. Shpesh gjykatat nuk i lejonin gjyqtarët të vinin, ose gjyqtarët vinin me shpenzimet e tyre, sepse nuk kishin fond të mjaftueshëm. Po kështu edhe prokuroria.

Gjithashtu, në pikën 6, meqenëse ne po e rregullojmë pozicionin e Shkollës së Magjistraturës dhe do të integrojmë te ligji “Për organet e qeverisjes vendore”, dua që bashkëpunimin e këshillave me Shkollën e Magjistraturës të mos e kemi kaq në mënyrë deklarative. Duhet përcaktuar qartë përgjegjësitë. Kur themi që këshillat bashkëpunojnë me Shkollën e Magjistraturës dhe miratojnë me vendim rregulla të hollësishme të programit, cili do të ishte roli i magjistraturës?

Pra, jo vetëm këshillat duhet të marrin vendim, por do të shikojmë edhe mundësitë. Pra, të ketë një detyrim reciprok se si do t'i kombinojnë këto këshilla me Shkollën e Magjistraturës.

Prandaj pikën 6, ndoshta e kam edhe për zotën Ibrahim, kur të përshihet pjesa e ligjit të Shkollës së Magjistraturës, të shikojmë që të mos biem ndesh dhe të rregullohen në mënyrë uniforme.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me nenin 5.

Neni 6. Papajtueshmëritë.

**Vasilika Hysi** – Thjesht është redaktim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 7. Kufizimet për shkak të funksionit.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 7 kam diçka për pikën 2, ku thuhet “magjistratë shtypi”. Ne nuk përdorim termin “magjistratë shtypi”, por herë përdorim “magjistrati i ngarkuar me marrëdhëniet me publikun”. Nuk e di e keni të njëjtën gjë? Këtë lloj termi dua ta kem në të gjitha ligjet.

**Fatmir Xhafaj** – Patjetër që kështu është, se nuk ka si të jetë ndryshe. Dakord.

Nuk ka nevojë për koment. Të mos i lodhim edhe ekspertët të bëjnë komente.

Neni 8. Ka ndonjë gjë?

**Vasilika Hysi** – Jo, është vlerësuar papajtueshmëria ambientale, që është përfshirë në këtë nen. E vetmja gjë që dua të them është nëse rrethi i personave që ne kemi përfshirë përkon me atë çfarë...

**Fatmir Xhafaj** – Termi “ambiental” qëndron?

**Vasilika Hysi** – Jo, kur them ambientale, duhet rregulluar...

**Fatmir Xhafaj** – Se unë e di që kemi përgjim ambiental.

**Vasilika Hysi** – Jo, unë thashë jam dakord me faktin që rregullohet parimi i konfliktit të interesave dhe nepotizmi deri diku. Terminologjia mund të rregullohet.

Nga ana tjetër, kam parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në vitin 2014 është shprehur në një vendim të saj lidhur me faktin a do të quhet nëse është kushtetuese ose jo kandidimi në një pozicion të caktuar.

Pyetja ime është: Rrethi i personave që është përfshirë në këtë paragraf, në paragrafin e parë të këtij neni, përkon me rrethin e personave që përcakton ligji për konfliktin e interesave, apo e kemi zgjeruar?

**Agnes Bernhard** *–(flet anglisht)* Ne i kemi referuar termit të përdorur në Kodin e Procedurës Civile. Të paktën grupi i punës ka propozuar që t’i referohemi terminologjisë së përdorur në Kodin e Procedurës Civile.

**Fatmir Xhafaj** – Më falni, a mund të ma shpjegoni këtë “papajtueshmëria ambientale”?

**Gent Ibrahimi** – Në shqip nuk është term fort i pëlqyeshëm, por është koncept i ri. Jo se nuk e kemi pasur si koncept, por nuk e kemi marrë kurrë mundimin t’i vëmë emër. Ne mund ta marrim përsipër që t’i gjejmë një emër të përshtatshëm.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Neni 8.

**Vasilika Hysi** – Në nenin 8, pika 4, mendoj se mungon diçka, ose në përkthim... Në nenin 8 pika 4 thuhet: “Në rast të evidentimit të rasteve të papajtueshmërisë ambientale në rastin më të parë, i cili këshilli i transferon magjistratin në gjykatën, prokurorinë i cili thotë: Jep miratim për transferim ka shkaktuar papajtueshmëri ambientale”. Germa “b” dhe “c” nuk kanë lidhje me fjalinë.

Këshilli nuk ka shkaktuar papajtueshmëri ambientale. Pra, këshilli transferon magjistratin në gjykatën ose prokurorinë më të afërt të mundshme, në rast se magjistrati përmbush të gjitha kriteret e parashikuara në rastin më të parë i cili jep”. Ka diçka, i gjithë paragrafi duhet rregulluar.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk rrinë me njëra-tjetrën.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Mendoj se është një çështje formulimi. Kuptimi i fjalisë është që këshilli duhet të transferojë në gjykatën më të afërt apo prokurorinë më të afërt të mundshme dhe duhet të transferojë atë magjistratë që jep pëlqimin, ose në qoftë se askush nuk e jep pëlqimin ,atëherë ka opsione të tjera që parashikon ligji. Pra, ndoshta duhet të ndahet në dy fjali për t’u bërë më e qartë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord neni 8 me riformulimin me ndryshimet në titull?

Neni 9. Veprimtaritë jashtë funksionit.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me veprimtaritë jashtë funksionit unë kam diçka lidhur me germen “c” te paragrafi 1, ku thuhet që: “Veprimtaria jashtë funksionit të paguar nuk e kalojnë 200 orë në vit, duke përfshirë edhe punën përgatitore për realizimin e veprimtarisë jashtë funksionit.”

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, te cila pikë?

**Vasilika Hysi** – Te neni 9, pika 1, germa “c”.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk bie ndesh me interesat thelbësore të funksionit.

**Vasilika Hysi** – Thuhet magjistrati lejohet të kryejë veprimtari jashtë funksionit vetëm nëse këto veprimtari... E përmendët me radhë, nuk bie ndesh me interesat thelbësore. Në

vazhdim të fjalisë thuhet: “Nuk lejohet të kryejë më shumë se 200 orë në vit, duke përfshirë edhe punën përgatitore për realizimin e veprimtarisë jashtë funksionit.”

Përlllogaritja e ngarkesës mësimore rregullohet në aktin ligjor, që nxjerr ministri i Arsimit. Ndërsa, puna në auditor është diçka tjetër. Si rregull fakultetet e drejtësisë kanë nevojë për kontributin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, sepse ndryshe vdesin...

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, por a do të ketë ndonjë ide të hartuesve që të ketë një kufizim, sepse ai mund të rri gjithë kohën dhe jam pedagog thotë.

**Vasilika Hysi** – Ka një gjë, zoti kryetar, meqenëse këtë pjesë e njoh mirë; po ju them që ai mund të vijë vetëm një leksion në auditor, por një leksion auditor ka një koeficient shumëzimi herë 3. Ai rri 1 orë e 60 minuta, por llogaritet sikur ka qëndruar dyfish, sepse llogaritet edhe koha e përgatitjes dhe ka mënyra konvertimit të ngarkesës.

Ndërkohë që shumë gjyqtarë sjellin përvojën e tyre. Nuk ka nevojë për ndonjë përgatitje speciale, sepse ata vijnë sjellin përvojën praktike.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Ka nevojë për një kufizim.

**Vasilika Hysi** – Po, ka, por orë faktike. Është më mirë ta rregullojmë me orët... Sepse po t'i hyjmë orëve se si llogaritet, sa kohë përgatitet...

**Fatmir Xhafaj** – Do ta ketë këshilli këtë kur të bëjë aktet e brendshme të këshillit.

**Vasilika Hysi** – E kemi thënë në ligj me 3/5-at.

**Fatmir Xhafaj** – Në bazë për zbatim të këtij ligji këshilli do të nxjerrë aktet, që do të rregullojnë elementet. Ta rregullojë këshilli, të mos merremi ne, jo 200, jo 150 orë.

**Vasilika Hysi** – Dakord. Akoma më mirë.

**Fatmir Xhafaj** – Të mos merremi ne si e ka Ministria e Arsimit. Pse detyra jonë është kjo?

**Vasilika Hysi** – Në rast se e vë në ligj me 3/5-at duhet të jemi të kujdesshëm. Nëse e lëmë pastaj...

**Fatmir Xhafaj** – Keni ndonjë gjë tjetër për nenin 9?

**Vasilika Hysi** - Më bie në sy shpjegimi që ka dhënë grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, që në rast se paga e magjistratëve nuk do të rritet sipas përcaktimeve të këtij ligji, ky rregull duhet të rishikohet. Me sa shikoj, angazhimin në veprimtarinë e mësimdhënies magjistratët e kanë pasur një mënyrë për të plotësuar pagat. Ndërkohë që unë kam një koncept pak më të gjerë.

**Fatmir Xhafaj** –Ju lutem, atëherë kur e ke ndryshe, lëre mos e merr. Është *footnote*. E kanë parë si... Pasi marrin edhe disa lekë një pjesë e tyre atje, marrin edhe disa të tjera këtu. Ky është koncepti që kanë shprehur këta këtu.

Dakord.

**Vasilika Hysi** – Pjesa tjetër janë riformulime nga ana gjuhësore

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me riformulimin dhe me sugjerimin.

Neni 10 “Organizimi dhe liria e të shprehurit”.

**Vasilika Hysi** – Në lidhje me këtë nen jam për ta riformuluar vetëm nga pikëpamja e teknikës.

**Fatmir Xhafaj** – Unë kam edhe një gjë këtu: Mos është momenti për ta qartësuar se çfarë janë këto shoqatat e prokurorëve dhe të gjyqtarëve?

E para, në formulim, ata që e kanë shkruar kanë vënë pikëm 1. Po pika 2, ku është? U ka humbur rrugës.

Dakord. Por këtu është momenti për ta qartësuar që organizime të tilla duhet të jenë të mirëpërcaktuara në këtë rast, si dhe statusin e këtyre shoqatave edhe të prokurorëve dhe gjyqtarëve, sepse shoqatat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve janë kthyer në institucione që dublojnë institucionet e sistemit.

**Vasilika Hysi** – Gjithashtu, në vazhdim të asaj që thoni ju, zoti kryetar, ku thuhet: “Këna të drejtë të marrin pjesë nëpër shoqata duke synuar ngritjen e tyre profesionale”, unë nuk e di nëse shoqata e prokurorëve dhe e gjyqtarëve a e arrin këtë ngritje profesionale se ...

**Fatmir Xhafaj** – Se çfarë bën, trajnimin bën?

**Vasilika Hysi** – Ekzakt. Po ngritja profesionale mund të jetë pak më e gjerë. Marrin pjesë Organizata e të Drejtave të Njeriut ose në organizatat, të cilat ofrojnë...

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Unë nuk e di nëse duhet ta rregullojmë në ligjin e statusit, statusin e shoqatave, por jam dakord që ndoshta është e nevojshme të sqarohet që këto shoqata nuk duhen të kenë detyrat që kanë organet qeverisëse.

**Fatmir Xhafaj** – Del e nënkuptuar. Unë nuk them që të ketë një rregullim të posaçëm se çfarë janë shoqatat e të tjera e të tjera, por ajo del e nënkuptuar nga qëllimi i përfshirjes së tyre në këtë dhe kuptohet edhe qëllimet që janë qëndrimet e shoqatave, e ka të qartë ligji.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Praktika në vendet e tjera e këtyre shoqatave është në fakt që ato, gjithashtu, promovojnë trajnimin e gjyqtarëve. Është një institut shumë i zakonshëm i



këtyre shoqatave. Për shembull, çdo vit shoqatat diskutojnë çështje të nxehta me gjyqtarët për të krijuar një forum, për shkëmbyer opinione dhe për të shkëmbyer ekspertizën ligjore dhe kjo është normalisht një nga qëllimet e këtyre shoqatave, por, sigurisht jo në mënyrë kaq sistematike dhe bazike, siç e bën Shkolla e Magjistraturës.

**Vasilika Hysi** – Që gjyqtarët dhe prokurorët mund të marrin pjesë përveç Shoqatës së Prokurorëve dhe të Gjyqtarëve edhe në shoqata të tjera, sepse ka shoqata europiane, të penalistëve e të tjera, por këtë duhet ta qartësojmë, sepse është aset të marrësh pjesë, të kesh kumtesa, prezantime, të shkëmbesh përvojë, ose të rrjeti europian i gjyqtarëve, ose të shqotat e prokurorëve europianë ka disa...

**Fatmir Xhafaj** – Po, mund të bëhesh edhe president atje?

**Vasilika Hysi** – Kjo është gjë e mirë.

**Fatmir Xhafaj** - Për shembull të rrjeti i këshillave bëhesh president edhe...

**Vasilika Hysi** – Këshilli i Europës dhe Bashkimi Europian i kanë filluar...

**Fatmir Xhafaj** – Duhet të dalin në Rinas dhe të presin me buqeta me lule. Po, dakord. Pastaj i fut një 3 çështje që merr nga 50 mijë euro dhe je në rregull.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dakord. U kuptuam, besoj edhe zonja Bernhard është dakord për një riformulim në nenin 10.

Dakord? Po, faleminderit!

Neni 11.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, në lidhje me nenin 11 do të flisja për të gjithë kreun 3. Kreu 3 bën fjalë për pagat dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore. Këtu do të flasim në parim, sepse ne ende nuk kemi një përgjigje zyrtare nga Këshilli i Ministrave.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Lidhur me nenin 11, që flet për parimin e caktimit të pagës dhe përfitimet financiare të magjistratit, në parim nuk ka absolutisht asgjë, neni është i rregullt, sepse në fund të fundit tregon mbi çfarë baze përlllogaritet diferencimi i pagave të magjistratëve të niveleve të ndryshme, por lidhur me këtë nen kam një pyetje për ekspertët që kanë punuar. A ka në Europë, në sistemet europiane modele që shpallin magjistratin më të mirë të vitit dhe japin shpërblim? E para.

E dyta: a ka shpërblim për një magjistrat që ka pajtuar çështje voluminoze dhe të një natyre të vështirë për t'u diferencuar në pagë?

E treta: a ka një skemë të mbështetjes së familjarëve, të fëmijëve të magjistratëve në vendet e Bashkimit Europian apo në vendet fqinje?

Këto pyetje që sapo bëra lidhen me paragrafin e tretë të nenit 11.

**Agnes Bernhard** –(*flet anglisht*) Paragrafi i tretë i referohet të themi nenit që përpunon më tej, pra përveç karakterit deklarativ edhe mund të hiqet, sepse shpjegohet më tej në nenet në vijim. Gjithashtu, ka edhe modele në fakt në vende të tjera që parashikojnë shpërblimet, diferencat në shpërblime, që parashikohen në ligj.

**Vasilika Hysi** – Unë nuk mund të flas, por kam për detyrë, në cilësinë e relatorit, t'u tërheq vëmendjen si komision për qëndrimin që duhet të mbajmë lidhur me skemën e pagave, të përfitimeve financiare dhe shoqërore të magjistratëve, por kurrësi nuk jam unë që vendos. Ajo që do të doja t'u bëja me dije të gjithë anëtarëve të komisionit është që në kapitull gjyqtarët kanë një sërë përfitimesh, përveç pagës financiare dhe shoqërore, jo vetëm ata, por edhe fëmijët e tyre, edhe bashkëshortet, pra familja në përgjithësi. Meqenëse, zoti Ibrahim më përmendi raportin e CEPEJ-it dhe unë kam tabelat e marra nga ky raport, shoh që ka një respekt që i bëhet propozimit për të pasur një rritje të pagave, unë jam absolutisht dakord që duhet të ketë një rritje të pagave, një përmirësim, një trajtim dinjitoz të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, por nuk jam në gjendje të jap një opinion për të gjitha këto përfitime shtesë, të cilat në tabelën që fut CEPEJ-i më shumë janë jo sesa po, në vendet, të cilat kanë një zhvillim ekonomik financiar shumë më të lartë dhe GDP-i shumë më të lartë se Shqipëria. Nuk do të doja kurrësi që ky kapitull të na riskonte të gjithë ligjin, ta bënte të pamundur zbatimin e tij dhe pas miratimit të ligjit të viheshim në një situatë që të falimentonim gjithë ekonominë e vendit. Paragrafi i tretë i nenit 11 lidhet pikërisht me kriteret se si do të jepen këto përfitime financiare. Unë nuk shoh asnjë gjë të keqe, zonja Agnes, që ky nen të rrijë, sepse duhet të ketë një standard, duhet thënë diku se cilat do të jenë kriteret dhe se si do të jepen këto përfitime, por pyetja ime ishte që për këto kritere, a ka gjyqtarë që marrin shpërblim në fund të vitit vetëm se është shpallur gjyqtari më i mirë në gjykatë?

E dyta, a ka në këto vende, se mua këtu më del që nuk ka sipas raportit të CEPEJ-it, ndërkohë që ne themi t'u paguhet shkollimi fëmijëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, t'u bëhet sigurimi i jetës në rast tërmeti. Po pse, qytetarët e tjerë nuk duhen siguruar, ata që punojnë,

punonjësit e policisë, të administratë, pasi të gjithë kanë nevojë t'u sigurohet jeta në rast tërmeti dhe fatkeqësish natyrore? Pse vetëm gjyqtarëve e prokurorëve, jeta e tyre është më e shtrenjtë kur ka fatkeqësi natyrore?

**Agnes Bernhard** –(flet anglisht) Sipas informacioneve të ekspertëve që hartuan pjesën kryesore të këtij, ka një standard, gjithashtu, edhe për gjykatësit e gjykatave të larta, ka një standard edhe për oficerët e policisë, të cilët janë në një rrezik më të lartë se sa zyrtarët e tjerë publikë dhe këtu në Shqipëri ka raste, për shembull kur gjykatësit janë vrarë për shkak të pozicionit të tyre. Pra, unë mendoj se është e arsyeshme që t'i mbrojmë ata për hir të pozicionit që ata mbulojnë.

**Gent Ibrahimi** – Pavarësisht nga propozimi që u bë këtu për nivelin e pagës të gjyqtarëve, ai do të vijë duke u qethur gjatë rrugës dhe në llogari të fundit gjyqtari shqiptar, gjithsesi, në terma absolutë, do të vazhdojë të paguhet pak, pavarësisht nga rritja që do të përfitojë si rezultat i kësaj reforme. Në këto kushte, nuk besoj se propozimi që është këtu do të kalojë filtrin tuaj, do të kalojë filtrin e qeverisë, do të kalojë filtrin e Ministrisë së Financave, do të kalojë filtrin e seancës plenare. Pra, kam përshtypjen që do të vijë duke u qethur, sikundër e thashë dhe në llogari të fundit nuk do të paguhej gjyqtari shqiptar aq saç do të meritonte të paguhej, por të paktën të ketë këto avantazhet dhe privilegjet e tjera.

**Vasilika Hysi** – Zoti Ibrahimi, unë e kam këtë ndjesi, sepse me aq sa kuptoj ata që kanë draftuar këtë pjesë të sistemit të pagave kanë qenë gjyqtarë dhe prokurorë shqiptarë, duke thënë që të kërkojmë shumë që të ngelet diçka, por unë jam relatore në këtë ligj dhe...

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, mos bëni supozime!

**Vasilika Hysi** – Do të doja që të...

**Fatmir Xhafaj** – Më falni që ju ndërpres, unë jam personi që e mbështes fort këtë kapitull, por duke ruajtur sensin e masës.

**Vasilika Hysi** – Të njëjtin mendim ndajmë. Unë e thashë që në fillim, që unë jam për rritjen e pagave...

**Fatmir Xhafaj** – Ne po bëjmë skanimin, vetingun e gjyqtarëve dhe ata që do të mbeten meritojnë një trajtim tjetër shumë më dinjitoz se sot në raport me dinjitetin që do t'i japin profesionit të tyre. Sot kemi një problem shumë të madh, sepse kemi kategori gjyqtarësh që e kanë çuar dinjitetin e profesionit në fund të këmbëve, e kanë rrëzuar përtokë dhe janë nga më të korruptuarit në këtë vend, por kemi edhe gjyqtarë që mundohen në këtë sistem që është krijuar të

ruajnë dinjitetin e tyre edhe të profesionit, por ama ka një konflikt të madh. Kështu që do të duhet të vendosim një ekuilibër dhe të mos bëjmë supozime se si i kanë menduar ata, është e drejtë e tyre, grup interesi janë dhe ne nuk ndeshemi për herë të parë me këtë gjë. Po t'i pyesësh edhe deputetë duan t'u bëjnë rrogën nga 3-4 herë, patjetër. Bëni sot një anketë me deputetë dhe do të thonë ne lodhemi, por vijnë në mëngjes firmosin e ikin dhe këtë e quajnë ditë pune.

Këtu jemi, pse për këta na duket e çuditshme dhe për të tjerët nuk ka duket e çuditshme.

**Vasilika Hysi** – Unë e thashë edhe në fillim të diskutimit...

**Fatmir Xhafaj** – Mirë pra, të vëmë sensin e masës, jam dakord me këtë. Ku do të fokusohemi konkretisht?

**Vasilika Hysi** – Tani jemi në diskutimin nen për nen, jemi fjalë për fjalë dhe unë duhet të shoh çdo fjali dhe çdo shprehje .

**Fatmir Xhafaj** – Absolutisht, jam dakord! Nuk të pengon njeri për këtë gjë.

**Vasilika Hysi** – Në ç'kuptim? Nëse ne, siç e thashë në fillim, ose do ta lëmë këtë kapitull dhe të mos e shqyrtojmë fare, të presim opinionin e Këshillit të Ministrave dhe të Ministrisë së Financave, ose ai ta sjell në një formë që të mos qethet, meqë zoti Ibrahimimi përdori fjalën “qethet”, por t'u japë dinjitetin gjyqtarëve dhe prokurorëve, t'u japë përfitimet dhe të gjitha privilegjet, por jemi ne komisioni përgjegjës, i cili duhet ta ruajë këtë dinjitet dhe t'u japë këto përfitime, por ta bëjmë që kur ta lexojë dikush të jetë e logjikshme. Në mënyrën siç është thënë del jashtë çdo mundësie për t'u paguar, është e pamundur. Atëherë, çfarë i bie kjo, ose çfarë do të diskutojë relatori? Nuk mund të diskutoj unë për këtë, pasi janë shumë nene, i bie 15 nene.

Lidhur me nenin 12 “Caktimi i pagës të magjistratit”, mënyra se si është shkruar me formula, logaritme...

A bëjmë një gjë? Të jepni të gjitha komentet që keni për këtë kapitull ju dhe të presim edhe atë të qeverisë dhe ndërkohë e kanë parë në këtë kontekst?

**Vasilika Hysi** – Siç e thashë edhe në fillim, jam shumë dakord që nuk mund të hyjë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Ju i regjistroni për të gjithë kapitullin, ata i mbajnë shënim...

**Vasilika Hysi** – Caktimi i pagës së magjistratit...

**Fatmir Xhafaj** – Më pas të shohim se çfarë do të sjelli edhe qeveria.

**Vasilika Hysi** - Jam dakord në parim, që duhet të ketë grupim të pagave sipas niveleve, ku të ketë shtesë për vjetërsi, të kemi parasysh edhe llojin e gjykatave ku ata punojnë dhe

angazhohen, por nuk jam dakord për të shprehur me formula matematikore, me funksioneve me  $x, y, z$  e të tjera. Prandaj, të gjithë nenin 12 kërkojmë ta riformulojmë dhe të jetë i qartë. Askush nuk e zgjidh dot këtë funksion me 2-3 të panjohura ( $S\% (1 > a + 2 - (a):2$ ). Nuk mundesh në një ligj të magistratëve të bësh këtë model. Unë nuk e di nga është marrë modeli, por të jenë të qarta paga dhe përqindja e shtesës.

Gjithashtu, po në këtë nen, jam dakord që magistrati të gëzojë të drejtën e sigurimit të detyrueshëm të jetës, të shëndetit, të pronës për shkaqe të lidhura me punën dhe ushtrimin e funksionit, absolutisht jam dakord, në raste sëmundjesh, por me fenomenet natyrore nuk e kuptoj dhe këtu unë reagoj. Fenomenet natyrore janë për të gjithë qytetarët, nuk janë vetëm për magistratin dhe me aq sa unë kuptova nga diskutimi i zonjës Agnes, e cila tha: “Kanë humbur jetën gjyqtarë”. Po, kanë humbur jetën, për shkak të funksionit dhe jo për shkak të fenomeneve natyrore ose pse gjyqtari pi dhe bën aksident. Duhet ta ndajmë gjithçka që lidhet vetëm me funksionin. Pra, pjesa tjetër që nuk lidhet me funksionin mendoj se nuk duhet të jetë, krijon pabarazi me qytetarët dhe pjesën tjetër të tyre që jetojnë në këtë shoqëri.

Gjithashtu, ju keni thënë këtu se duhet t’u paguajmë shkollën e lartë fëmijëve. Nuk e di në Austri, në Gjermani, në Itali, të gjitha qeveritë, shteti paguan nga buxheti arsimimin e të gjithë fëmijëve të magistratëve dhe të prokurorëve? A krijon kjo një pabarazi? Aktualisht, të gjithë i kanë për çerdhe, shkolla private, shkolla amerikane internacional që janë me mijëra euro.

Lidhur me nenin 13, kam një pyetje për paragrafin 4 në të cilin thuhet: “Magjistrati i komanduar merr pagën më të lartë ndërmjet dy pagave”. Cilat janë dy pagat? Pse merr pagën më të lartë midis dy pagave?

Gjithashtu, në nenin 14 flitet për shtesa për pozicionet drejtuese dhe me aq sa unë vë re shtesat këtu janë 5-10%. A mendoni ju që paragrafin 2 dhe 3 t’i përmbledhim e t’i thjeshtojmë pak? Me aq sa unë shoh shtesa nuk kanë vetëm drejtuesit, por edhe këshilltari i etikës. “Magjistrat udhëheqës” çfarë do të thotë? Janë disa terma që futen në këtë nen, të cilat nuk i kemi të përkufizimet.

Lidhur me nenin 15, në të cilin flitet për magistratin e deleguar, i cili merr një shtesë 40% të pagës fillestare për pozicionin në skemë, cila është arsyeja që rritet paga 40%? Në disa vende paga ulet 1%, në disa të tjera merr, pra nuk arrij të kuptoj paragrafin e parë. A mendoni ju që rritja e pagës në këtë nivel në rastin e një magistrati të deleguar mund të shërbejë si mundësi

që magjistratë të caktuar të kërkojnë që të delegohen përkohësisht, që të kenë përfitim më të madh?

Gjithashtu, te nenet 1 dhe 2 unë do të doja t'i sqaronim më qartë rastet e përfitimit të pagave. Ju thoni: “Për çdo ditë të ushtrimit të funksionit merr 2% të pagës shtesë”. Pra, 2% të pagës fillestare bruto për çdo ditë në ushtrimin e funksionit. Sa është totali? 2 % e pagës për çdo ditë, bëhet fjalë për pagën ditore apo mujore? 2% e 22 ditë pune, i bie gati 45% ose më shumë. Pra, unë nuk jam financiere, por më duket gjuhë shumë e sofistikuar. Kush e ka bërë kapitullin e pagave dhe shpërblimeve, se nuk arrijmë dot të nxjerrim totalin e pagave shpenzimeve dhe përfitimeve që ka një magjistrat në bazë të ligjit

Gjithashtu, kam një pyetje në lidhje me shpërblimin për aftësi. Ne mendojmë që po bëjmë një reformë në drejtësi për të pasur gjyqtarë të aftë. Të jesh i aftë dhe të punosh profesionalisht nuk besoj se duhet marrësh shpërblim. Të gjithë duhet të jemi të aftë dhe të punojmë profesionalisht. Këtu thuhet: “Do të marrë një pagë shtesë ai që është vlerësuar si më i miri”. Me këtë logjikë i bie që duhet të marrin shpërblim shumë njerëz, të cilët punojnë nëpër institucione më shumë se të tjerët. Cila është arsyeja? Kush e shpall magjistratin më të mirë të vitit?

Njëkohësisht, po te neni 16, rezulton që këshillat kufizojnë të drejtën përfitimit për 10% të magjistratëve në vit, pra, do të ketë 10 % të magjistratëve, që do të marrin shpërblim, dhe përcaktohen kriteret e zgjedhjes së magjistratëve çdo vit. Atëherë pyetja ime është: CEPEJ-i e ka propozuar, i ka bërë rekomandim Shqipërisë që të futet skema e shpërblimit të gjyqtarëve më të mirë? Cilat janë kriteret e gjyqtarit më të mirë? Kush merr vlerësim “Shumë mirë” promovohet, ngrihet në detyrë e të tjera. Që të kesh vlerësim shumë të lartë etik është minimumi. Pa vlerësim , nuk mund të jesh gjyqtar e prokuror, po që të marrësh shpërblim se je sjellë moralisht mirë, mua nuk më bën sens.

Lidhur me shpërblimin për fëmijët. “Magjistrati gëzon të drejtën për të marrë shpërblim për çdo fëmijë për edukimin 5% të pagës fillestare bruto të tij, pra, për çdo fëmijë të rritur”. Kjo më kujton formulën që e kemi pasur para viteve ‘90 për nënat me shumë fëmijë, sa më shumë fëmijë të kishe, aq më shumë shpërbleheshe.

Gjithashtu, lidhur me kreditë për shtëpi, unë jam dakord që për një pjesë të mirë të magjistratëve është mirë të lehtësohet krijimi i familjes së tyre, të kenë mundësi për të përfituar kredi, që të bëjë një jetë me dinjitet, por mendoj se kjo dispozitë duhet riparë. Në ka njeri që

duhen ndihmuar, duhet të jenë magjistratët e rinj, por kur ne themi: “Të ketë ushtruar jo më pak se tre vjet detyrën”, nuk po ndihmojmë të rinjtë.

Lidhur me përfitimet e tjera financiare, neni 19, unë mendoj se nuk mund t’i lihet çdo këshilli që t’i përcaktojë vetë kriteret dhe kushtet shtesë për uljen e pagave. Këtu duhet të ketë një lidhje shumë më të fortë me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe qeverinë. Këshilli nuk mund të vendosë thjesht, duke marrë një mendim nga Ministria e Financave, sepse, me sa kuptoj, mendimi i këshillit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Financave nuk është detyrues. Pra, këtu kemi lënë këshillin që të vendosë lidhur me shtesat për kushtet për shtesat e të tjera, por këshilli mund të vendosë gjëra që bien ndesh me politikat ekonomike financiare e të tjera.

**Fatmir Xhafaj**- Ta bëjmë: “Të jetë një akt i përbashkët midis këshillit dhe...”.

**Vasilika Hysi** – Pra, bashkëpunimi midis këshillit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave duhet të jetë i tillë që, pa prekur pavarësinë, vendimmarrjen e tyre, të jetë më i koordinuar.

Lidhur me nenin 20 “ Bursat e shkollimit për kandidatët magjistratë”, për sa i përket pagesës mendojmë se te paragrafi i parë të hiqen formulat, funksionet matematikore dhe të kalohet direkt te përfitimi, pra sa përfiton studenti në vit të parë, të dytë dhe të tretë, po kështu të hiqet formula në paragrafin e dytë. Është shumë e vështirë për t’u zbatuar, por të thuhet konkretisht sa janë përfitimet, kaq % më e lartë se kjo pagë, siç e kemi pasur në ligjet që kemi sot, që janë më të thjeshta për t’u zbatuar.

Lidhur me pikën 3, nuk arrij të kuptoj shprehjen: “Pika 3 e nenit 27 të këtij ligji të zbatohet për aq sa është e mundur”. Kjo lloj fjalie është përdorur shpesh në ligj. Do ishte e mirë që të thuhet: “Parashikimet e bëra në pikën 3 të nenit të këtij ligji zbatohen. Kush do ta përcaktojë “për aq sa është e mundur”?

Lidhur me nenin 21 “Mbrojtja e veçantë e magjistratit për shkak të ushtrimit të funksionit të tij”, jam dakord. Magjistrati e meriton të ketë një mbrojtje të veçantë gjatë punës së tij.

Lidhur me nenin 22 “Shpërblimi për ndërprerje të parakohshme të funksionit”, e kam thënë edhe në diskutimin që kemi bërë për ndryshimet kushtetuese thuhet: “Magjistrati që del në pension përfiton menjëherë shpërblimin prej 6 pagash mujore bruto të pagës fillestare”. Ne kemi edhe një ligj për pensionet, kemi miratuar edhe një strategji dhe një skemë të pensioneve, në këtë kuadër do të dija, cili është argumenti që mund të jepet për pagën 6 shpërblim kur del në pension?

Gjithashtu, te paragrafi i dytë thuhet: “Në rast se magjistrati vdes gjatë ushtrimit të funksionit fëmijët në moshën 18 vjeç, nën moshën në moshën 25 vjeç, që ndjekin studimet, përfitojnë shpërblimin sipas pikës 1”, pra, marrin 6 paga shpërblim. Ky shpërblim do të jepet për çdo fëmijë? Kjo është për çdo rast të vdekjes së magjistrati, edhe kur jeta e tij ikën për shkak të detyrës apo edhe kur pëson një aksident, apo për shkaqe të tjera jo të ligjshme?

Gjithashtu, lidhur me pensionin suplementar, këtu ka një ligj për pensionet suplementare të ndryshuara, duhet rregulluar kjo, sepse referimi në ligj nuk është i saktë. Ne kemi ndryshuar ligjin “Për pensionet suplementare”, madje e kemi amenduar edhe dje, pra referenca duhet bërë e plotë. Nuk jam në gjendje të flas sot, pasi nuk jam specialiste e fushës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, por ju thoni: “Pension suplementar deri në 60 % të pagës referuese”. Unë nuk e di skemën e pensioneve, ndoshta ekspertët duhet të na japin më shumë informacion, por nuk besoj të kemi pensione të tilla në këtë nivel.

Gjithashtu, thuhet: “Në rast paaftësie magjistari, i cili deklarohet invalid i përhershëm, gjatë ushtrimit të funksionit përfiton pension shtetëror suplementar për invaliditet në masën 60%”, këtu duhet të rregullojmë terminologjinë. Kjo duhet të shihet në raport me ligjin për pensionet suplementare për shkak të paaftësisë. Kurrsesi nuk mund të ketë nivele, të cilat bien ndesh me skemën. Në këtë kuadër do të ishte mirë që të uleshim dhe të shikonim në tërësi edhe ligjet tjera që preken nga ky ligj. Nuk duhet të prekim kaq shumë ligje, të cilat janë të sapomiratuara, për shembull, skemën pensioneve e miratuam vitin e kaluar.

Lidhur me pensionin familjar, nenin tjetër, neni 25, përsëri kam të njëjtën kërkesë, të shihet në lidhje me luginë pensioneve, të ndryshuar. Pra, referenca nuk e është e saktë në ligjin, sepse ligji ka ndryshuar.

Neni 26 flet për një përfitim tjetër tani, përfitim maksimal nga sigurimet shoqërore. Termi “përfitim maksimal” nuk ekziston në ligj. Duhet ta shikojmë në raport me ligjin. Ju thoni: “Duhet të përfitojë 90% të pagës referuese në sigurimet shoqërore”. Nuk e di nga e kanë gjetur këtë ekspertët që kanë punuar.

Neni 27 flet për paprekshmërinë e pagës dhe përfitimet e tjera financiare të magjistratit. Në këtë kuadër do të doja të kemi parasysh referimet, ndryshimet që kemi bërë në Kushtetutë te neni 138, për uljen e pagave, por nga ana tjetër mënyra si është formuluar këtu paragrafi 1, te pika 1 e nenit 27, ka nevojë të rishikohet.



Gjithashtu, për germën “c” të neni 1, ku thuhet: “ka masë disiplinore”, “paga mund të ulet për shkak të masave” duhet të bëhet referimi, siç e kemi bërë në Kushtetutë, të përdoret e njëjta terminologji kur ulet 1/3-ta e pagës, sipas masave disiplinore. Nuk arrij të kuptoj në një ligj me 3/5-at, paragrafin e tretë ku përcaktohet pika referuese e llogaritjes së inflacionit dhe thuhet: “tëtori i vitit 2015”. Domethënë, si ka mundësi të përcaktohet muaji tetor i vitit 2015, dhe inflacioni ka qenë 118.92. Ky është një ligj që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, nuk është një ligj që rregullon Bankën e Shqipërisë. Inflacionin e kemi në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë. Në një ligj për gjyqtarët dhe prokurorët nuk mund të marrim të dhëna, të cilat zyrtarisht, në bazë të Kushtetutës, i ka për detyrë t’i deklarojë dhe ne i referohemi gjithmonë Bankës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër, sugjeroj që neni 27 të riformulohet totalisht, duke e zhveshur, duke mos marrë referenca dhe duke mos marrë referime në vite në përqindje të infalcionit në ligj, por duhet thënë që t’i referohemi periudhës përkatëse, kur hyn ligji në fuqi, sipas përlllogaritjes që bëjnë organet kompetente në një shtet dhe në rastin konkret te ne i nxjerr Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, kam një pyetje për ekspertët për paragrafin 4 të nenit 27 ku e detyrojnë Këshillin e Ministrave që të rishikojë një herë në 2 vjet, buxhetore pagën referuese të magjistratëve. Unë jam dakord që Këshilli i Ministrave do t’i kërkojë Kuvendit të shikojë pagën një herë në dy vjet. Po pse vetëm pagën e gjyqtarëve? Po pagën minimale? Po pagën e administratës pse nuk duhet ta rishikojmë? Pse duhet të bëjmë rishikim të pagave një herë në dy vjet për magjistratët? Kjo do të krijojë një pabarazi shumë të madhe, për një vend ku ne nuk dimë ende minimumin jetik dhe paga mesatare nuk është se rishikohet çdo vit.

Për ta mbyllur këtë kre dhe, meqenëse kam folur më shumë se të tjerët do të doja edhe një herë, zoti kryetar për të më mirëkuptuar, në cilësinë e relatores, jam që kreu 3 të qëndrojë, pra të ketë rritje pagash, përfitime dhe shpërblime, por kurrsesi nuk do të doja që me një ligj të tillë të cenojmë strukturën hierarkinë e pagave në Shqipëri. Së dyti, të krijojmë pabarazi, edhe midis njerëzve që kanë funksione risku në Shqipëri, sepse i bie më pas të ngrihen të gjithë autoritet, edhe doganat, edhe tatimet, edhe institucionet e tjera në kuadër të luftës kundër korrupsionit, të kërkojnë për të bërë një gjë të tillë.

E treta, kjo pjesë të shkruhet qartë, thjeshtë, pa formula funksionesh, logaritmesh e të tjera.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

A ka ndonjë gjë tjetër ngas kolegët?

Unë e mbështes linjën e arsytimit dhe të komenteve që parashtrori relatorja lidhur me këtë kre, siç mendoj se e njëjta logjikë është edhe për kreun pasardhës, që ka të bëjë me pjesën e pushimeve, pra duhet e njëjta vëmendje dhe i njëjti kujdes për t'u trajtuar.

Askush nuk vë në diskutim, siç e thamë edhe gjatë mbledhjeve të mëparshme, faktin që kemi nevojë për një trajtim tjetër financiar dhe jo vetëm financiar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, por do të na duhet që hapat që hedhim të jenë të kujdesshëm, që do të thotë, të jenë hapa të kujdesshëm në raport, së pari, me të gjitha të drejtat që kanë kolegët e tyre minimalisht të paktën në rajon.

Së dyti, të jenë në raport me gjendjen ekonomike që ka vendi.

Së treti, të jenë në raport me pjesën e perceptimit publik që është sot për rolin, punën dhe përgjegjshmërinë e tyre. Kjo do të thotë që ne do ta bëjë këtë hap, por duhet të jemi të kujdesshëm për t'i lënë mundësi që gradualisht ky lloj vlerësimi ose shpërblimi të vijë duke u rritur në raport me shkallën e përgjegjshmërisë së treguar. Natyrisht, për këtë gjë ne nuk jemi ekspertë të mënyrës si llogariten ato, nga ana tjetër, Kushtetuta ka parashikuar detyrimin që Këshilli i Ministrave duhet të shprehet për këtë gjë dhe ne e kemi dërguar.

Për të ndihmuar këtë proces do të kisha dy sugjerime: sugjerimi i parë është, nëse brenda ditës mundeni së sotme, të na jepet një analizë mbi të cilën është arritur në këto përfundime. Pra, do të thotë ka një dokument që e përmendi zonja Hysi, të CEPEJ-it. Dakord. Atëherë, le t'i marrim gjithë këto zëra që kemi vënë ne në ligj dhe të themi që Shqipëria i ka vendet e rajonit, anëtare apo jo të Bashkimit Europian, përfshirë këtu edhe Kroacinë, Slloveninë që e kanë GDP-në shumë herë më të lartë se GDP-ja jonë, por edhe vendet e tjera që janë në rajon, në mënyrë që të mos shkojmë më tej, të mbetemi te rajoni i Ballkanit, të themi si pasqyrohet çdo zë nga këto, pastaj të themi se cili është vendimi përkatës e CEPEJ-it për Shqipërinë, nëse ka një rekomandim konkret, për t'u orientuar, jo për të qenë të urdhëruar nga CEPEJ-i. Ky dokument është shumë i rëndësishëm, që ne të arsyetojmë drejt.

Gjithashtu, do të donim që personi që ka punuar nga stafi, ditën e hënë të ulet bashkë me ekspertët e Ministrisë së Financave dhe ekspertët e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, që ka të bëjë pikërisht me pjesën që lidhet me lejet, me pensionet e të tjera në mënyrë që t'i shohin një për një mbi këto argumente dhe mbi këtë analizë krahasimore, të kemi një qëndrim definitiv ku të orientohemi mbi këto principe.

Kjo është për sa u përket krerëve 3 dhe 4, për të cilat duhet të kemi një analizë krahasimore, studimore. Personi do të angazhohet për ta përballuar të gjithë këtë proces në diskutim me ekspertët e qeverisë nën kujdesin tim, për shkak se do të jem i angazhuar personalisht për ta ndjekur këtë grup pune, kjo do të thotë se do të marr pjesë vetë në atë tavolinë për ta ndihmuar debatin midis përfaqësuesve tanë, ekspertëve që do të angazhojmë ne, dhe përfaqësuesve të qeverisë.

Nga ana tjetër, do të kërkoja që të dy ju zonjat e Sekretariatit Teknik, zonja Saliu dhe zonja Vogli, që meritojnë përshëndetje dhe vlerësim për punën që kanë bërë në mbështetje të ekspertëve të nivelit të lartë për këtë gjë, të ulen me Zonjën Hysi për t'i parë gjatë kësaj fundjave, që të kemi mundësi që për nenet që vijnë në vijim, të mos merremi me detaje, për riformulime e të tjera, të cilat sa kohë që zgjidhen për efekt të teknikës legislative, e lehtësojmë punën tonë këtu për të qëndruar në gjëra më parimore, për të debatuar në gjëra më parimore. Kështu që fundjava le të shërbejë për këtë qëllim. Më vjen që do t'ua marr fundjavën, me zonjën Hysi e kam më të lehtë, por shpresoj që edhe me dy zonjat e tjera të sekretariatit të ndaj të njëjtin mendim për këtë rast.

Këtu e mbylлим për sot.

**Vasilika Hysi** - Zoti Kryetar, janë tre kapituj, që rregullojnë përfitimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pra të marrim edhe kreun 5, ku janë të drejta të tjera si pensioni i parakohshëm, ulja e ngarkesës, pagesat e studimeve jashtë shtetit. Pra të shohim tre krerët 3, 4 dhe 5.

**Fatmir Xhafaj** – Të hënën do të fillojmë direkt me shqyrtimin e nenit 33 dhe në vazhdim.

Por do t'ju lutesha të kemi një punë përgatitore për efekt të teknikës legislative, në mënyrë që të kursejmë kohën e njëri-tjetrit.

Ditën e hënë do të fillojmë direkt me nenin 33 “Kriteret e pranimit, formimi fillestar” dhe nenet në vijim.

Dakord. A keni ndonjë gjë zoti Brahimi?

Zonja Bernhard.

**Agnes Bernhard** - Po, dakord. Pyetja është vetëm për analizën nëse do të donit të uleni së bashku me institucionet e tjera, mendoj se për këtë na duhet më shumë kohë. Ndoshta të martën. Nëse ulemi së bashku të hënën, mund të jetë të martën.

**Fatmir Xhafaj** – Keni shumë të drejtë.

Zoti Ibrahim.

Faleminderit të gjithëve!

Fundjavë të mbarë, duke lexuar dhe duke punuar!

## **MBLEDHJA MBYLLET**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*